



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i VIII i botimit, nr. 122, dhjetor 2013

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Gëzuar Krishtlindjen dhe Vitin e Ri 2014


PARADOKSE TRISHTUESE

Nga Lazer Kodra

FASADË...!

Ç'do të mbetet njeriu po t'i hiqet lëvozhga?-pyeste një shkrimtar. O Zot na ruaj nga tipa të tillë, të cilëve po t'u hiqet lëvozhga humbasin të gjitha trajtat njerëzore dhe lavditë e shpifura. Keni parë ndonjëherë që injorantët imponohen si të dijsëm? Keni parë ndonjëherë që të paaftët përdorin llafallogjinë fallco, fasadën, e cila është në të vërtetë mjete më efikas për të mashtruar injorantët. Dhe për njerëz të tillë është fatmirësi po të kenë përballë një 'botë injorantësh', sepse aty shitën më çmime mar-ramendëse! Kjo bota jonë e vockël, brenda së cilës jemi mbyllur, e meriton t'i ser-virësh një meny të tillë.

3



SEPSE PERËNDIA E DESHI AQ BOTËN, SA DHA BIRIN E TIJ TË VETËMLINDURIN, QË, KUSHDO QË BESON NË TË, TË MOS HUMBASË, POR TË KETË JETË TË PËRJETSHME.

UNGJILLI SIMBAS GJONIT 3:16

KE-ja foli shqip

Në qershor 2014 (s') do pranoheni kandidatë të BE-së Deri tre muaj me parë populli dhe politika kanë ecur kundër njëri-tjetrit dhe as që bëhej fjalë për një dakordësi të Bashkimit European për pranimin e Shqipërisë si vënd kandidat. Vlerat dhe integriteti perëndimor as janë synuar, as janë mënduar nga politikbërësit tanë dhe as janë kërkuar seriozisht nga Bashkimi European. Vetëm tre muajt e fundit qasja duket serioze për nga Brukseli dhe interesi i BE-së reflekton besim. Por tre muaj janë pak dhe qeveria Rama ka fatin e keq që është qeveri post Berishë.

2

vizitoni faqen tonë të internetit me adresë:

shoqatadukagjini.com

MËSUES DHE NJERËZ TË MIRË QË KUJTOHEN ME RESPEKT



5

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP



Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA

Ma.di.sh **Kimay**
PRODUCTION PRODUZIONE GIACCHE



KE-ja foli shqip

Në qershor 2014 (s') do pranoheni kandidatë të BE-së Deri tre muaj me parë populli dhe politika kanë ecur kundër njëri-tjetrit dhe as që bëhej fjalë për një dakordësi të Bashkimit Europian për pranimin e Shqipërisë si vënd kandidat. Vlerat dhe integriteti perëndimor as janë synuar, as janë mënduar nga politikkbërësit tanë dhe as janë kërkuar seriozisht nga Bashkimi Europian. Vetëm tre muajt e fundit qasja duket serioze per nga Brukseli dhe interesi i BE-së reflekton besim. Por tre muaj janë pak dhe qeveria Rama ka fatin e keq që është qeveri post Berishë. Ky Berisha që çirret edhe më katolik se Papa në rrugën drejt BE-së, ka ecur indetro, duke instaluar presion politik dhe ekonomik mbi opozitën dhe duke ndërtuar një sistem të kontrolluar mbi drejtësinë, mbi policinë, mbi financat, ushtrinë, pronat, bizneset, diplomacinë ... Ka ndërtuar modelin e një De-

moni për Europën. Për këto arsye të tjera jo më pak potencial seriozisht korrupsionin, pa ndërhyrë në sektorin e pronave se edhe pas qershorit 2014 të marrin dënimet e t'u sekuestrohen pasuritë tërë atyre pushtetarëve që nisën rrugën me 'panolina' nëpër këmbë e sot janë milionerë. Ndoshta drejtësia kërkon gjyqtarë e prokurorë të huaj, se zor hajduti të dënoi hajdutin. Këtë tha me fjalë të tjera ambasadori amerikan Alexander Arvizu, kur u shpreh qartë, shqip: 'Shumë prokurorë e gjykatës e kanë vëndin në burg.' Në fakt, nga verifikimi i ndërtimeve pa leje, apo me leje në ambiente publike atë tjetërsuara më dokumente falso, ku pas çdonjërit fshihen milion-

at e eurove, askush nga pronarët nuk del pronar, por të zotët na qënkam pushtetarët, politikanët, hetuesit, prokurorët, gjykatësit, drejtorët, kryekomunarët ... Pra këtë radhë KE e tha mesazhin shqip: Qeveria Rama kërciti në derë të BE-së, por nuk duhet të punoi si qeveria Berisha. Të mos harrojmë, në 2005-sën Beri-

sha u rikthye në pushtet pikërisht me sloganin: 'Me duar të pastra.' Fatos Nano dhe shumë të akuzuar nga ai për korrupsion, shumë shpejt u bënë aleatë të tij. Pra, ju e shihni që nuk ishin kushte as tre ligjet, as legalizimi i të drejtave të komunitetit gay, asgjë që trumbetonte Berisha për tu pranuar kandidatë në BE. Qeveria aktuale në fakt e ka më të vështirë dhe tani që Europa e ka marrë seriozisht tërheqjen e Shqipërisë në familjen që i takon, 'gurët' e Ramës nuk do godasin aty ku goditën 'gurët' e Berishës. Berisha, sa kohë ishte në pushtet, nuk ishte shumicë. Me 'gurë' në xhep, si pelegrin fallco, megjithëse edhe djali edhe vajza i faleshin pesë herë në ditë në xhami, në vënd të gjuante 'djallin', pra korrupsionin, padrejtësitë, gjuajtë kundërshtarët politikë dhe tërë ata që aspironin model qeverisjeje dhe jetese europiane. 'Gurët' e Ramës duhet të qëllonjë në shenjë, edhe kundër të korrupuarve në kampin e vet, pra kundër 'djallit' që KE do e vlerësoi në qershor 2014. Duhet edhe të reflektoi se është shumicë, duke ngritur edhe politikën në stadin e qeverisë, që normalisht e ka lart, më lart se asnjëherë tjetër në tërë historinë e shtetit shqiptar.

Sokol Pepushaj


Ne sheshin "Nene Tereza" ne Shkodër ku asht monumenti i Nene Terezës dhe monumenti i Luigj Gurakuqit duhet të shtohet edhe monumenti i Marin Barletit

Në qendër te qytetit 2500 vjeçar te Shkodres gjendet "Sheshi Nene Tereza" ne te cilin asht vendose monumenti i humanistes se madhe dhe nobelistes se pare shqiptare Nene Tereza (1910-1997). Kjo grua e madhe shqiptare ia ka përkushtua jetën e vet BAMIRSISE te varfërve pa shikue përkatësinë etnike apo te bindjeve fetare. Asht për ketë arsye qe kjo grua shtatvogël dhe me zemër te madhe nderohet nga e gjithë bota. Asht kjo grua shtatvogël me zemër te madhe qe ka nxjerre popullit shqiptar te rritur dhe te edukuem me traditat fisnike te gjakut shqiptar dhe qe njikohesisht e ka ba te njoftun ne mbar boten popullin e vet.

Po ne ketë shesh asht vendose edhe monumentit i birit te famshëm te Shkodres Luigj Gurakuqit (1879-1925), për te cilin mund te flitet me faqe te tana qofte për patriotizmin e Tij, për ndershmeni dhe si përhapës i kulturës dhe edukimit te brezit te ri.

Por ne ketë shesh mungon edhe nji figure tjetër shume e rëndësishme qe ka nxjerre popullin i Shkodres, qe ka dhanë kontribut tepër te madh jo vetëm për Historinë e Shkodres, por

edhe për Historinë e mbar popullit shqiptar. Pra mungon monumenti i humanistit te shquem, historianit, te parit autor te njohur dhe një nga më të mëdhenjtë e letërsisë së vjetër shqiptare Marin Barletit (rreth 1460 Shkodër - 1512-1513).



Veprat e Marin Barletit qëndrojnë si një burim i dorës së parë e të pazëvendësueshmit për historinë e shekullin XV të Shqipërisë, si dhe të Evropës Juglindore. Veprën e vet ai e mendonte si një përmendore që ia kushtonte luftës për liri të atdheut dhe popullit të vet; ajo nuk do të kishte një funksion thjesht estetik, por do t'i shërbente së vërtetës, si mësuese e jetës, që

do t'i mësonte njerëzit për «të hapur sytë e për të drejtuar si duhet punët e njerëzimit. «Historia e Skënderbeut» e Barletit u bë burimi më i rëndësishëm, nga ku patriotët shqiptarë mësonin historinë e luftërave të lavdishme të popullit tonë nën

udhëheqjen e Skënderbeut dhe frymëzoheshin për përpjekjet e tyre për shpëtimin dhe lirinë e Shqipërisë. Me librin e tij Marin Barleti qëndron në fillimet e letërsisë shqiptare, e cila e nis udhën e saj me një vepër të përmasave të mëdha. Kjo vepër është shkruar në latinisht, që asokohe ishte gjuha e kulturës në Evropë, por ajo i përket kulturës shqiptare, jo vetëm se

është shkruar nga një shqiptar, por se është bota shqiptare që i ka dhënë jetë këtij argumenti madhështor të kulturës së hershme të këtij populli të lashtë.

Nji vepër tjetër e këtij shkodranit te madh Marin Barletit asht edhe "Historia e jetës dhe e bëmave të Skënderbeut" (Historia de vita et rebus gestis Scanderbegi, Romë midis 1508 dhe 1510). Është vepra madhore e Marin Barletit. Ajo e tregon autorin si një shkrimtar të nivelit të lartë dhe si historian që përpigjet të ndërtojë kuadrin e saktë të jetës së heroit dhe, me gjithë vështirësitë objektive për të siguruar burimet, jep njohuri të gjera për «Ç'ka ngjarë në shekullin XV dhe çfarë zhvillimi ka pasur në atë kohë shoqëria jonë, fshatarësia shqiptare, jo vetëm nga ana historike, por edhe nga ana kulturore, ekonomike dhe drejtme të tjera». Autori mbron të drejtën e një populli për të jetuar i lirë, himnizon njeriun dhe forcën e tij, heroizmin njerëzor dhe dashurinë e natyrshme për trojet e të parëve. Duke qenë një vepër historike, libri i Barletit ka rëndësinë për të dhënat dhe faktet që sjell. Pa këtë vepër historiografisë për Skënderbeun do t'i mungonin burimet e para, që

e kanë ushqyer dhe vazhdojnë t'a ushqejnë edhe sot.

Vepra tjetër me rëndësi te madhe asht edhe "Rrethimi i Shkodrës" (De obsidione Scodrensi, Venedik 1504). Ne ketë vepër Ai jep historinë dramatike të luftës për jetë a vdekje të banorëve të Shkodres së rrethuar për një vit nga osmanët në vitin 1478-79. I mbështetur në shënime e kujtimet e veta si dhe të pjesëmarrësve të tjerë, libri jep një tregim të saktë të ngjarjeve politike-ushtarake, por sidomos të aspektit të brendshëm, të vetëdijes së lartë patriotike të banorëve të qytetit. Shkruar në latinisht dhe e botuar në Romë rreth viteve 1508-10. Kjo vepër në kohën e vet u ribotua latinisht tri herë dhe u përkthye në disa gjuhë evropiane. U përkthye në anglisht për herë të parë në vitin 2012 si "The Siege of Shkodra" nga intelektual i mirëfillte amerikan me banim ma se 20 vjeçar ne Shkodër zotni David Hosaflook. Ky bir madh i Shkodres dhe i mbar popullit shqiptar me veprat e tij i ka dhanë shume Shkodres dhe shqiptareve, prandaj Shkodra ia ka borxh nderimin tue i vendose nji monument ne sheshin qendror "Nene Tereza". Paul Tedeschi

PARADOKSE TRISHTUESE

Nga Lazer Kodra

FASADË...!

Ç`do të mbetet njeriu po t`i hiqet lëvozhga?-pyeste një shkrimtar. O Zot na ruaj nga tipa të tillë, të cilëve po t`u hiqet lëvozhga humbasin të gjitha trajtat njerëzore dhe lavditë e shpifura. Keni parë ndonjëherë që injorantët imponohen si të dijshtëm? Keni parë ndonjëherë që të paaftët përdorin lla-fallogjinë fallco, fasadën , e cila është në të vërtetë mjete më efikas për të mashtruar injorantët. Dhe për njerëz të tillë është fatmirësi po të kenë përballë një 'botë injorantësh', sepse aty shiten më çmime marramendëse! Kjo bota jonë e vockël, brenda së cilës jemi mbyllur, e meriton t`i servirësh një meny të tillë. E pse jo...kur e kapërdin me shije të madhe deri në duartrokite të tërbuara. A kishte fasadë Sokrati more Zot?-Jo! Po si drejtin u bë aq i ditur pa fasadë, ndonjëse jetoj njëzet e pesë shekuj më parë?! Po Diogjeni pati fasadë apo jo? Po Danteja? Po Ajshtajni pati fasadë apo jo? Shikojeni pra, se ku mbizotëron dituria dhe mendimi racional nuk ka nevojë për fasadë. Ja, bie fjala ... të lyesh muret, të kallkanosësh kravatën të ngrish flokët me pak llak, të afrosh dy-tre servilë rreht vetes dhe mjafton të krijosh 'opinion', e gjitha kjo falë stilit të injorantëve përballë injorantëve. Ju kujtohet Labirinti i mbretit Minos? Nëse nuk ju kujtohet le ta përmendim. Mjeshtri i madh Dedal e ngriti atë (Labirintin) me qindra dhoma e kthina, pastaj për veten e tij 'fabrikoj' një palë krahë e iku m`at anë detit. Oh ç`fasadë të bukur që kishte Labirinti!-Por ç`e do, se brenda ndodhej Minotauri, një shartesë

gjysma njeri e gjysma kokë kafshe njerëzore, i cili ushqehet çdo ditë me mishin e djemve e vajzave të reja! Kujdes njerëz! Fasadat janë mashtruese. Mjaft kemi paguar për to! Nëse nuk besoni, patjetër do ta psoni!



Hiq fytyrën, vendos maskën!

MJERIMI MEDIATIK

Kohë më parë një miku im , që punon në një TV-lokal, më tha:-E di ti se 90% e gazetarëve të Shkodrës janë me shkollë të mesme?-M`u duk pak e çuditshme, por pasataj u binda, mbështetur mbi ato që ndoqa më me vemendje në ekranet e televizioneve. Sigla shfaqet:EMISIONI I LAJMEVE! Sa bukur do të ishte, po të kishte lajm! Të ushqyer nga 'nëna parti', pasi të gjithë e dimë përkatsinë e tyre, dhe njëkohsisht të urdhëruara nga 'nënat'

e mëdha TV-kombëtare, reminishenca të të cilave janë këto 'zoçkat' e vogla, menjëherë fillojnë me lëvdata e klasifikime, që vetem një drejtin e di se ku i kanë marrë të dhënat!-Nuk e kanë për gjë që një komune t`i vendosin epitete të tilla :-e shkelqyera; i shkelqyeri; e pakrahueshmja; e rregullta e drejtin bindu se ku marrin këto të dhëna sonduese për të arritur në këto përfun-

TV lokal. Himne e komente të pafund ...për...për asgjë, përveçse një sajese aq të paprincipitë e të pasojshme, ndërkohë kur e jep të njëjtën kronikë TV-kombëtar 'nënë e voccrakut' nxjerr në pah një problematikë skandaloze për kronikën në fjalë! Atëherë më erdhi në mendje Napolon Bonopardi, i cili në çdo vend që pushtonte kërkonte të binte kambana, dhe njëherë nuk ndidhi kjo gjë. Ai pyeti:-Përse nuk bie kambana?-I thanë njëmijë e një arsye, por e fundit ishte se në atë zonë nuk kishte këmbanë fare! Kujdesni miq të TV, pasi populli është më shumë se një njeri apo grup njerzish që duan të mbrojnë interesa të ngushta nëpërmes jush.

FALEMINDERIT ZOTI AMBASADOR!

Atë , që ne trembeshim ta thshonim hapur, ambasadori Anglez e shprehu në mes të një konference për gjakmar-rjen: Në Shqipëri problemi i gjakmar-rjes është kthyer në industri biznesi. Shoqata të tëra bëjnë çnmos për të rrëmbyer fonde brenda e jashtë vendit gjoja për të mbyllur këtë plagë! Po ne ku ishim more njerëz?! Nëpër kafe e kemi bërë qindra herë këtë bisedë, por ama në media e në publik u kemi thurë himne ketyre shoqatave. Sa mungesë vetëdije! Sa frikë! Sa skllavëri! Sa turp! Ne nuk mund të çlirohemi nga vetëvetja! Po ku janë ata 39 fëmujë të ngjuar në rrethin e Shkodrës, të cilët janë të deklaruar nga një shoqatë e tillë? Sa deshirë do të kisha për t`i lexuar emrat e tyre ne një listë, që tq paktën të kisha mundësi për të ndihmuar ndonjërin. Faleminderit Z.ambasador për sherbimin që na bërë! U desh fjala Jote që të çlirohemi nga vetëvetja. Po tani ç`presim? Hë?-hajt të lëvizim!

dime! Po kështu ndodhë me shkollat. Përsëri epitete:-më e mira; model për krahinën; staf profesional të shkelqyer etjerë! More zotërinjë ku i mërrni këto të dhëna?-Keni ndonje vlersim nga institucionet përkatëse në mënyrë që t`u referoheni? Keni ndonjë statistikë vjetore të pasqyrës së rezultateve nga e cila mund të citoni fakte? Nëse jo...bëni kujdes, sepse nuk shitet një ekran, që është pasqyra e shikuesit, as për pak mbështetje politike, as për pak servilizëm dhe aq më tepër për pak para të pista. Kronika e disa ditëve më parë ishte shumë befasuesu, tek një

KËNAQËSI TË SHKRUAJ PËR NXËNËSIN TIM, JOZEF SOKOL PROGNI!



Nxënësin Jozef Sokol Progni e kam njohur para një viti nga pozicioni I mësues se lendes se gjuhës gjermane. Qe ne orën time te pare ne ketë lende me tërhoqi vëmendjen një djalë energjik, i qeshur, inteligjent, i sjellshëm, me peshe ne shoqëri e klase dhe pa frike mund te them, qe lehtësisht kuptohej qe ai ishte "burim energjie" për gjithë klasën.

Me durim hapa regjistrin për te bere apelin dhe te mësoja emrin e këtij djali, qe ulej ne bankën e pare. Ngritja e tij ne këmbë dhe mënyra se si me tregoi, qe ishte i pranishëm ne klase me la te kuptoj krenarinë, qe ai mbarte me vete. Përshypja qe Jozefi me la, mendoj ishte arsyeja qe unë asnjëherë nuk e ngatërrova emrin e tij, siç ndodh zakonisht kur njeh nxënëse te rinj.

Është kënaqësi për mua qe një fëmijë si Jozë është nxënësi im e për me tepër nen kujdestarinë time. Dhe sot te shpre-

hem për Jozin ne pozicion e mësuese kujdestare përveç se kënaqësi është edhe përgjegjësi.

Arsyeja e këtij shkrimi për Jozin me qartësoi krenarinë e tij, te cilën e spikata qe ne fillim. Kështu kuptova qe ai i njeh mire rrënjët e tij, e di mire nga vjen, ndjehet krenar dhe e vlerëson. Gjithashtu kuptova atdhedashurinë e Jozit, te shfaqur kurdo qe trajtohen tema te tilla. Kjo është për tu vlerësuar ne kohen qe jetojmë.

Jozë është i rritur dhe i edukuar me vlera dhe me dashuri te pafundme për dije.

Ai është një nxënëse shembullor me rezultate te shkëlqyera ne te gjitha lendet.

Ai është shembull ne sjelljen e tij kudo e me këdo, shume i dashur me mësues, shoke e shoqe. Mirësia dhe zemërgjerësia e tij bën te jete gjithmonë i gatshëm t`u gjendet pranë shokëve e shoqeve.

Te gjithë e duan shume.

Një dite, ne pushimin e madh, hyj ne klase dhe te gjithë i gjejnë kulmin e lojës. Kjo e tepërt brenda ambienteve te klasës. Një nder ata qe mori kritika nga unë ishte dhe Jozë. Nuk do e harroj asnjëherë kur ne fund te orës se mësimi, Jozë m`u afrua dhe me tha: "Mësuese, ne emër te familjes Progni, te kërkoj falje! Pjekuria dhe ndjeshmëria e tij te le gjithmonë pa fjale. Nuk ka si te jete ndryshe Jozë.

Dashuria, kujdesi dhe përkushtimi i nënës se tij, te cilën e takojë thuajse çdo dite kur sjelle Jozin ne shkollë, ka bere qe Jozë te jete ky qe është: Krenari e prindërve, e familjes, e klasës, pse jo dhe e shkollës.

Shpresoj te jem shprehur mjaftueshëm për Jozin, për shkak te kohës se shkurtër qe e njoh. Te tjera vite shkollore na presin se bashku dhe për Jozin do flasin arrijtet qe ai do beje ne shkollë dhe ne jete, për ketë jam e sigurt. Suksese Jozë!

Mësuesja kujdestare, **Nikolina Guri**

ZYDI BARBULLUSHI, KUJTIMET E MIJA PËR DODË TAHIRIN SI E KAM NJOHUR DHE SI E ÇMOJ DODË TAHIRIN? -

(vijon nga nr. 121)

A keni ndonjë kujtim të pathënë për Dodë Tahirin?

Kam shumë kujtime, kemi luajtur kundër "Buducnostit", ish skuadrës së Dodës, të cilën në vitet e para pas çlirimit e kemi mundur katër herë, disa ndeshje me "Cetinën" në Shkodër, dy ndeshje me "Hajdukun" e famshëm në fitore 2:1 dhe një humbje 3:0, ku patëm marrë në ndihmë Qamil Telitin dhe Sllave Llambin.

Si qëndron historia e humbjes së hidhur me "Dinamon e Zagrebit"- "Vllaznia" 7:0?

Mbas çlirimit, "Vllaznia" ka luajtur disa ndeshje me "Zagreb", por në këtë takim pësua një disfatë të rëndë. Ishin pothuaj të gjithë lojtarët e kombëtares që kishim marrë pjesë në Ballkaniadë. Pra shkuam në emër të "Vllaznisë", si kampione e vitit 1946. Fillimisht kërkuam që ndeshja të shtyhej, pasi mbërritëm në Zagreb të shtunën në mengjes. Rruga prej Nikshiqit deri në Sarajevë ishte jo vetëm e gjatë, por edhe malore ku autobusi ecte me shpejtësi diku deri mbi 10 km në orë. Ky udhëtim i gjatë qe një tundim rraskapitës për ne, por edhe koha shumë e ftohtë, terreni i ngrirë ishin të gjitha në dizfavorin tonë. Kërkesa jonë për të shtyrë ndeshjen nuk u mor parasysh, pasi kishin nxjerrë lajmërimet, duke thënë se Shkodra kishte në përbërjen e saj pothuaj të gjithë lojtarët e Kombëtares që kishte fituar Ballkaniadën. Luajtëm shumë keq, pasi nuk ishim mësuar në terrene të ngrira. Rexhep Spahiu, që në fillim ju ngri muskulatura dhe doli nga loja. Formacioni pati të meta pasi në vend të lojtarëve tonë. që nuk u morën, u futën lojtarë të Tiranës, të cilët nuk arritën të harmonizojnë veprimet si duhet. Për mendimin tim u gabua që nuk kishim marrë me vete Muc Koxhën, Met Vasinë, Bahri Kavajën e ndonjë tjetër rezervë. Vërtetë u pësuan 7 gola, por sikur të mos kishte qënë Doda në portë do kishim pësuar akoma më shumë. Gjithsesi, Tahiri është ndier më keq se të gjithë ne të tjerët, pasi tifozët e njohnin dhe e çmonin si portier.

Gjatë rrugës në Podgoricë thuhet se ka pasur një incident mes Tahirit e Adem Smajlit. Si ndodhi ngjarja?

Kur mbërritëm në Podgoricë, u mblodhën shumë njerëz tek makina jonë dhe njohën Dodën, që kishte luajtur në kohën e Zogut me "Podgoricën" dhe "Cetinën". Dikush na tha se paskeni edhe Dodo Shekovin. Unë e pyeta Ademin, çka don me thanë "Shekovi"? Ademi mu përgjigj se ba me ditë çka don me thanë! ... e duke qeshur ma tregoi. Kur kaluam nga Podgorica në Danilograd për të shkuar në Nikshiq, prej nga do të niseshim me tren për në Zagreb, Doda thotë:

"Kam ardhë me luajte me gjimnazin e "Cetinës" një herë në Dalilograd, ku ai kishte një shkollë bujqësore si ajo e Kavajës dhe na patën rrahë me shkopinj me gunga. Shuaip Keri, (që kishte ardhë si lojtarë rezerve) ashtu si unë, nuk dinte se çfarë do të thoshte "Shekovi", i thotë Dodës për

t'u tallur: Bre Dodë, si të ka mbete llagapi Dodë Shekovi? (që në shqip do të thotë Dodë Qerosi).

Doda desh ta rrihte Shuaipin, por u mjaftua duke thënë: Jemi në Jugosllavi se ta kisha tregu mirë qefin. Kur mori vesh se këtë sekret ia kishte thanë edhe Ademi, iu sul edhe Adem Smajlit, por ky i tha:

- Jo more Dodë, nuk e kam thanë vetë.

-Meqë Doda e donte shumë Ademin ia ktheu: S'kam çka me të ba ty more Adem!?

Mbani mend ndonjë episod tjetër?

Kur po ktheheshim nga Zagreb për në Splid, shkuam në një restorant, Broziviçi, kapiteni i "Hajdukut" filloi të flasë me Loro Boriçin, madje duke e ngacmuar për çështje femrash, ndërkohë çohet edhe Doda të flasë me të. Ademi që kishte një humor të hollë i thotë Dodës;

- Shaji more vendit se ti, megjithëse hëngre 7 gola në Zagreb, e dëftove vetin se pret edhe ndonjë top jashtë portës.

Doda, iu përgjigj flakë për flakë akoma ma me humor, Ademit:

-Kuku për mue, ma mirë të kisha ardhë vetëm se me çiftat e tu, e me na turpnuje, pasi qe besa e burrave nuk ka lujtë Zagreb ("Dinamo") me "Vllazninë", por vetëm me Dodën.

Pas kësaj ndeshje Doda me t'u kthyer në Shkodër është larguar nga Shqipëria

Pas ballkaniadës pati ndonjë grumbullim tjetër të kombëtares para se të vinin disfatat e njëpasnjëshme të vitit 1947, qe nga vendi i parë u rrokullisëm në të fundit?

Mbas fitores së Ballkaniadës, u grumbullua serish ekipi kombëtar në Tiranë, mua më thirrën në Kombëtare me Dodë Tahirin, Bimo Fakjën, Loro Boroçin, Bahri Kavajën dhe Muhamet Dibrën. Midis tyre unë qeshë më i riu, sapo kisha mbushur 20 vjeç. Na caktuan në fillim në hotel "Park" dhe na caktuan të hanim në një restorant mbrapa Bashkisë. Ndonëse nuk kisha shkollë dhe futbolli nuk ishte profesion me gjetën një punë në Bashkinë e Tiranës (me një plak ruaja pasuritë e regjencës së ish kriminelëve të luftës). Për vendosjen tonë në punë interesohet direkt K. Q. i Rinisë dhe Ramiz Alia, pasi ai e kishte në patronazh ekipin kombëtarë të futbollit

Po me shokët tuaj ç'u bë?

Dy shokët e mi të ngushtë, Bimo Fakja e Dodë Tahiri në Tiranë mbetën pa punë. Bimon deshën ta sistemonin në punë roje në ministri, si portier. Po kur ia propozuan këtë vend ai u qe përgjigj:

"Unë luaj alfë dhe portier luan Doda" e ashtu i nervozuar Bimoja pat marrë valixhen e desh të kthehej në Shkodër. Megjithatë, me ndërhyrjen e shokëve, ndryshoi mendje të mos e merrte atë veprim pasi një gjë e tillë mund të kishte pasoja.

Dodës i kishin premtuar se do ta vishnin ushtarak në Ministrinë e Mbrojtjes. Ai në ndryshim nga shumica e brezit tonë kishte arsimit e mesëm të përfunduar në Podgoricë. Gjithsesi, të vetmit sportist të kombëtares, që mbetën pa punë, qenë Doda e Bimo Fakja.

Me sa di unë, Dodës iu vu një kusht, që

të mobilizohej kapter, duhej të luante për "Partizanin", që sapo ishte krijuar, por Dodës nuk i ka pëlqyer të linte Shkodrën për "Partizanin" dhe kështu mbeti pa punë. Doda ishte tip qefli, shëtitës dhe nuk i përshtatej dot disiplinës ushtarake dhe të jetonte në kazermë. Ai e donte shumë "Vllazninë" dhe synonte kampionatin e tretë radhazi. Përforcimi i "Partizanit" me lojtarë shkodranë dhe nga rrethet e tjera, nuk i pëlqej Tahirit, prandaj kur e kuptoi se "Vllazninë", Federata me duart e saj po e çarmatoste për hatër të "Partizanit", Doda iku në Podgoricë tek "Buducnosti" i tij, duke e lënë skuadrën e zemrës në maje të futbollit, por që do të rrezohet që atë vit për të mos u ringritur më për 26 vjet, deri në vitin 1972, kur portën do ta mbronte pasardhësi i tij i shquar Paulin Ndoja dhe në skenë do rilindte garda e re e viteve gjashtëdhjetë-shtatëdhjetë

Si stërviteshit atëhere në kombëtare?

Para se të fillonte Kampionati Ballkanik i vitit 1947, na liruan një muaj nga puna dhe filluam stërvitjen me një trajner tjetër të quajtur Jeftiç, i cili kishte luajtur në Spanjë. Për të njohur nga afër gjendjen e lojës e taktikën e ekipeve kundërshtare na çonte me pa "Partizanin" e Jugosllavisë në Titograd dhe Shkup. Ky trajner kishte sistemin e vjetër akademik, me spostime të gjata, gjë që nuk e kisha luajtur asnjëherë. Prandaj, për këtë arsye, nuk kam qënë i mirë në përdorimin e topit me kokë, por kam qënë përfekt me të dy kembët, si alo i majtë dhe alo i djathtë. Ndërkohë që Skënder Begeja, nga që nuk pati sukses në atletikë, tani pas largimit të Broçiçit, donte të vinte përsëri në Kombëtare në pozicionin alo i majtë, ku më përpara kishte qënë Pal Mirashi. Një ditë, Skënder Begeja më tha: Nuk do të isha më në Kombëtare. Ishte e qartë se ai donte të vinte vetë në formacion, mëqe ishte përgjegjës i kombëtares. Mua, pas Ballkaniadës më kishin thirrur për të zëvendësuar Pal Mirashin si alo i majtë, i cili kishte rënë në burg politikisht, me akuza të pabëra pasi ai në të vërtetë qe dënuar pasi i kishte dhënë një sahat të kushtueshëm Skënder Jarecit. Më kujtohet se kombëtarja jonë me trajner Jeftiç bëri një ndeshje miqësore me "Vllazninë". Unë nuk bëja pjesë në formacionin e Jeftiçit. Më kujtohet se në këtë takim Lutfi Laçja luajti shumë mirë, pasi kishte ardhur i përgatitur nga skuadra e "Partizanit".

Si është e vërteta e një zënke të Dodës me Skënder Begenë që përflitet që u bë shkas që Doda të braktiste Kombëtarin?

Siç e theksova më përpara, Skënder Begeja ka qënë përgjegjës i ekipit kombëtar të futbollit, njeri që kishte miqësi dhe komunikim të drejtpërdrejtë me Ramiz Alinë, ndonëse një vëlla e kishte pasur me qëndrim jo të mirë politik. Skënderi, ishte njeriu i partisë në Kombëtare. Nuk pati luajtur asnjë ndeshje në vitin 1946 me Broçiç, kthehet me Jeftiç dhe bëhet i pazëvendësueshëm në vitin 1947, vit në të cilin Shqipëria të katër takimet e luajtura i humbi duke marrë 13 gola kundrejt 2-ve të shënuar. Nuk jam në gjendje të them

si ka filluar konflikti Begeja-Tahiri, por u interpretua se, u zunë për punë ushqimit apo dietash. Doda u ankua hapur se ushqimi ishte i dobët dhe i pamjaftueshëm për një sportist të Kombëtares dhe i kërkoi llogari se pse nuk i kishte shënuar lekët e dietave. Skënderi, që kishte plotësuar formularët e dietave, Dodën e kishte lënë pa gjë fare. Unë nuk kam qënë prezent, por u fol mes nesh se Skënderi replikoi ironikisht duke i thënë se dietat t'i konvertojmë në makarona, ndërsa Doda iu përgjigj me një shputë të fortë dhe për këtë hëngri një vërejtje të rëndë paralajmëruese. E di dhe jam dëshmitar okular se Doda jo vetëm tek "Vllaznia", por edhe në Kombëtare ka qënë nga lojtarët më popullor, i drejte dhe korrekt që nuk i kapërdinte padrejtësitë. E di shumë mirë se nuk ka pranuar të bëhet pjesë e "Partizanit" kur u formua ky ekip. Unë nuk besoj se Doda u largua nga Kombëtarja thjesht për një konflikt që pati me Skënder Begenë, ndonëse u diskutua deri lart, madje duhet theksuar se Skënderi reagoi në menyry të kulturuar duke thënë: Unë isha fajtor, ndonëse Doda e teproi ndaj meje.

Doda është zhgënjyer nga trajtimi i dobët që i është bërë (pa punë, me ushqim të dobët edhe buka me racion 300-400 gr).

Ai vinte shpesh tek unë në furrë, por edhe me shokë të tjerë të cilët, me sa mundja i ndihmoja. Shkaku kryesorë i largimit, me sa di unë, ka qënë mërzia që e kapte për Podgoricën, mbasi ai atje kishte familjen, mbasi atje pati kushte shumë më komode se në Shqipëri. Të mos harrojmë se Doda ka qënë nënshetetas malazez. Këtu në Shqipëri flitej se kishte edhe një hasmëri të vjetër. Gjithsesi, Broçiç kur u rikthye të merret serish drejtimin e Kombëtarë sonë, ka pyetur i habitur:

- Ku është Dodë Tahiri?! Apo ua mori Mali i Zi!

Mos vallë ka pas edhe ndonjë histori dashurie që ka ndikuar për këtë vendim të Tahirit?

Doda është martuar pas largimit nga Shkodra me një serbe, Natashka Tahiri. Me këtë vajzë është njohur kur ajo vazhdonte studimet në gjimnazin e Podgoricës.

Doda kishte lidhje dhe afeksione të fuqishme me vendin fqinj ku ishte rritur. Ai nuk na ka rrëfyer për ndonjë histori dashurie, ndonëse ishte në qendër të vëmendjes së shkinave, për të cilat nuk e fshehte dot simpatinë që kishte për to.

Cilët kanë qënë miqtë më të ngushtë të Tahirit?

Ernest Helepjani, Adem Smajli, Muhamet Dibra, Prekë Gjeloşi, Loro Boriçi, Bimo Fakja, Beqir Osmani, Bahri Kavaja. Me mua dhe Pal Mirashin që ishim më të rinj ka qënë shumë korrekt, asnjëherë nuk i ka përbuzur të rinjtë. Në gjysmën tjetër të Kombëtares kishte miqësi sportive me Qamil Telitin, të cilit i kishte zbrapsur shumë predha idhnake, Rexhep Spahiu, Aristill Parapanin, sidomos me Shahiv Demnerin e Tiranës, kishte marrëdhënie shumë të mira. Dodës i pëlqenin njerëzit me karakter burrëror si Sllave Llambi, Aristill Parapani e të tjerë.

Di shumë mirë se, Doda simpatizonte futbollin Gjerman dhe Hungarinë e atyre viteve

Intervistoi, Prele Milani

MËSUES DHE NJERËZ TË MIRË QË KUJTOHEN ME RESPEKT

- triptik -

Prenda Lekçaj (Çeli) tani është në pension. Ka punuar shumë e shumë vite në arsim, në Dukagjin, Pukë, Lezhë. Nga të gjitha anët dëgjojmë vetëm fjalë të mirë, respekt, mirënjohje. Është lindur në Vuksanaj të Shalës dhe ka mbaruar shkollën për mësuesi dhe asaj ju kushtua gjatë gjithë jetës së saj. Ajo ka dy vajza, tashmë të rritura dhe në jetën e tyre. Janë me fëmijë dhe mësuese Prenda ndjen kënaqësisë e tyre. Fatkeqësisht prej kohësh i është ndarë nga jeta bashkëshorti i saj Gjon Lekçaj.



Jeton në një shtëpi në qytetin e Lezhës prej vitesh. Mësuese Prendën e takova para pak kohe, pas më shumë se 40 vjetësh. Unë e kam pasur mësuese në vitin 1960-1961. Në vitin 1959 çelët shkolla 7 vjeçare e detyrueshme në Theth, kështu ishte atëherë. Klasa jonë ishte e dyta që vinte në radhë që vazhdonin shkollën 7 vjeçare. Ajo është drejtorja e parë në të gjithë historinë e shkollës së Thethit. E kujtoj shumë punëtore, e vogël nga trupi por shumë energjike. Qe në atë kohë ajo përgatiste mjete mësimore për të konkretizuar mësimin. Jepte edhe lëndën e botanikës, kështu quhej atëherë lënda e biologjisë. Gjente njerëz që vizatonin mire dhe së bashku përgatisin skema e vizatime të bimëve, rrënjëve të tyre, gjethe, lule, ose edhe i mblidhte në fshat e na i sillte në shkollë.

Unë e mendoja se nuk jetoonte në Shqipëri, dhe kisha shumë dëshirë që ta shikoja, jo vetëm si ish drejtorja dhe mësueseja ime, gjë që është shumë e rëndësishme, por edhe si një bijë e Dukagjinit, si ndër të parat vajza që u shkolluan, që u morën me edukimin e nxënësve, që fillimisht punoj në vendlindjen e saj, në Shalë. Të kujtosha dhe të

takosh mësuesin tënde pas 50 vjetësh është shumë bukur, nuk të del koha që ti flasësh të gjitha. Mendimet vinë vullshëm, sidomos në raste të veçanta, por kur nuk të mjafton koha ti shprehësh, ato flenë ndoshta edhe për shumë kohë, e mbase përgjithmonë.

U takuam në një kafe në qytetin e Shkodrës. Ajo kishte ardhur qëllimisht për tu takuar edhe me një shoqe të sajën dhe me këtë rast edhe me mua. Së bashku me time shoqe, Gjysten, shkuam me kënaqësi. E gjetëm së bashku me shoqen e saj ndër-sa bisedonin vullshëm për kohë të kaluara, gëzime, hidhërimeve, vështirësi, kënaqësi. Megjithëse në moshën mbi 75 vjeçe, sapo na pa u ngritë me shpejtësi në këmbë dhe na përqafoj si të ishim fëmijët e saj. Ju mbushën sytë më lot edhe për mua edhe për Gjysten sepse "jo radhë flinim bashkë në një shtrat në shtëpinë e babait të saj në Breglumi".

Ishte përsëri e shkathtë, me shëndet të mirë, më shikim që kërkonte të depërtonte sa më thellë. Vetëm thinjat kishin mbuluar kokën e saj, por këto vetëm i kishin shtuar fisnikërinë.

Filluan pyetjet e përgjigjet, për fëmijët, migracionin, i thirrëm kujtesës të gjithë së bashku, sa fillonte njëri ndër-rhynte tjetri. U kujtuan shumë nxënës, banorë, veprimtari, kolegë të saj mësues, për sa punoj në Theth, por edhe më tej.

Pas disa orësh, që kaluan pa u ndjerë, si të na i vidhte dikush, u ndamë me dëshirë për tu takuar përsëri.

Prenda Lekçaj është nga ata njerëz, që me punën e saj krijojnë ndjesinë për tu respektuar gjithnjë nga të gjithë, për të mos u harruar shumë gjatë në kujtesën e nxënësve të saj dhe banorëve më të cilin ishte aq dashamirëse.

Aishe Hoxha (Karaj) është lindur në Tiranë dhe lëvizjet e kohës e thirrën drejt Alpeve Shqiptare. Ajo nuk nguroj dhe erdhi nga Tiranë dhe filloj punën e mësueses në Breglumi të Shalës. Por pas një viti emërohet drejtoreshë e shkollës në Theth. Në këtë kohë unë nuk isha më nxënës, e kisha mbaruar shkollën 7 vjeçare. Ajo gjeti shokun e jetës në Shkodër, Ismail Hoxhën, që është ndarë nga jetë 2 vjet më parë.

E ftuam që të takoheshim dhe ashtu u bë. Ajo erdhi me gjithë qejf. E shkathtë si gjithnjë,



me një veshje të kohës dhe në kokë mbante një kapuç dimëror pasi ishte pak ftohte. Ajo ka dy djem tashmë të rritur. U kujtuan shumë e shumë nxënës dhe banorë, veprimtari, kolegë të saj në Theth apo Breglumi. Ajo kishte sjellë me vete edhe shumë fotografi të asaj kohe, diku ndërsa fliste në përrurimin e elektrifikimit të zonës në Breglumi, diku më nxënësit në Qafë të Ndërmajnës, diku në shokët dhe shoqet në Theth, e shumë e shumë të tjera.

Aishja ka shumë qejf që të flasë dhe dëgjojë shumë për Thethin dhe Dukagjinin në tërësi. Ka dëshirë që të di si shkon turizmi, si është zhvillimi i përgjithshëm.

Ajo tregon se në kohën që punonte si drejtoreshë shkollë në Theth, punuan shumë për higjienizimin e fshatit në vazhdim të nismës që kishin marrë mësuesit dhe fshati Theth pak kohë më parë. Mësuesit në atë kohë ishin shumë të pranishëm në familjet e fshatit, ndihmonin dhe punonin edhe vetë praktikisht për përhapjen e dijes dhe të kulturës ndër malësorët e Thethit.

Kam punuar me përkushtim shumë të madh kudo ku kam shkuar, thotë Aishja, por në mënyrë të veçantë në Dukagjin. Kënaqem kur dëgjoj fjalë të mira për Dukagjinin dhe dukagjinasi kudo që janë. Kam parë se janë bërë shumë veprimtari në Shkodër nga shoqata Dukagjin apo edhe nga të tjerët për Dukagjinin, të cilat më kanë pëlqyer shumë, por edhe më ka marrë malli për të qenë e pranishme në ndonjë prej tyre, pasi e ndjej vetën se kam një pjesë të qenies time dukagjinase dhe do e ruaj sa të jem gjallë.

Lan Gjetja. Po afrohej fundi i viteve '60. Në Theth është mësues edhe Lan Gjetja, nga Shkodra. Ishte i ri, energjik dhe i ishte

përkushtuar punës në arsim. Ishte familjarisht, pavarësisht se bashkëshortja nuk punonte në arsim. Ai kujton me respekt Nikë Tomën, Lekë Simonin, Tone Logun që punonte në shtëpinë e pushimit të punëtorëve në Theth, Prekë Ndo, përveç drejtoreshë së shkollës Aishe Hoxha kujton edhe mësuesit Berhan Ademin, Jozefina Dema, Bisere Hafizi, Vjallca Kaja, Sami Bushati, Tusha Jubani, Saxhide Lluçaj, e te tjera. ndihmësmjekun Angjelin Bazhdari. Ai tash është në moshën e pensionit, por mbahet shumë mirë, ka kujtesë të kthjelltë, lëvizë, merret me ndonjë punë të vogël.



Në ato vite kam një kujtim personal me mësuesin Lan Gjetja. Ishte njeriu i parë që më nxiti për tu futur dhe për të punuar në arsim. Jo se nuk kisha unë dëshirë, por rrethanat ashtu e sollën. Si pothuaj të gjithë moshatarët e mijë edhe unë doja që të punoja në marrëdhënie punë me shtetin. Kishte shumë vështirësi. Nuk e mendoja se mund të futesha në arsim, sepse nuk dihej se si mund të bëhej. Një ditë po bisedoja me Lanin, sikur të ishim miq të vjetër, ndonëse ai atë vite kishte ardhur në Theth, por nga që merresha me drejtimin e organizatës së rinisë kishin filluar njohjet tona, sepse në atë kohë mësuesit, shkolla dhe rinia zhvillonin shumë veprimtari të përbashkëta. Unë ja shpreha dëshirën time që të kisha një punë në marrëdhënie me shtetin, ndërsa po ecnim buzë lumit. Ai më dëgjoj deri në fund, pastaj më këshilloj të të interesohesha për të punuar në arsim, sepse sipas ati, qeveria kishte vendosur për të përfshirë në punën mësimore dhe edukative nxënës që kishin mbaruar me rezultate të larta shkollën 7 vjeçare, pasi ishte shtrirë arsimit i detyruar 7 vjeçar në të gjithë vendin dhe kishte mungesë për

mësues. U interesova në shkollë por më thanë që nuk dinin gjë për këtë. Shkova në Komitetin ekzekutiv të Lokalitetit Dukagjin. Ata nuk e mohuan dhe as e pohuan por me thanë bëje një kërkesë më shkrim që ta kemi në dosje. Ashtu bëra. Pas disa kohe, në një kohë që pothuaj se e kisha harruar, pasi kisha filluar punën si magazinier në kooperativën bujqësore, më thirrën dhe me emëruan në punë si mësues në Pult. E përmenda këtë rast për dashamirësinë që tregoj Lan Gjetja ndaj meje. Unë u arsimova në të gjitha nivelet dhe punova në të gjitha instancat e arsimit para universitar për afër 45 vjet, si mësues dhe drejtues. Por edhe për një fakt tjetër. Kur biseduam nuk patëm mundësinë të pinim as një kafe bashkë me Lanin. Ai u transferua në një shkollë tjetër në afërsi të Shkodrës, unë fillova punë, siç thash. Me ka rënë shpesh në mend për mësuesin Lan Gjetja, e kam kërkuar ndonjë herë por më shumë kohët e fundit. Më ndihmoj Aishe Hoxha dhe e takova. Ishte përsëri me shëndet të mirë, ndonëse flokëbardhë, por energjik, kishte shumë dëshirë për të kujtuar atë periudhë të shkurtër, por e mjaftueshme për tu kujtuar për të mirë. Nuk është shumë e nevojshme që të qëndrosh shumë gjatë në një vend për të fituar respektin e duhur. Kështu ndodhi edhe zotin Lan Gjetja, për të cilin jo vetëm unë por të gjithë banorët e kujtojnë me shumë respekt.

Kafeja që pimë ditët e fundit ishte një kafe e munguar atëherë, ishte si një "borxh" pas rreth 45 vjetësh, ishte një kafe respekti e mirënjohjeje për dashamirësinë e pa interes, por vetëm për ti bërë mirë punës dhe mua.

Është bukur kur njerëzit hynë në kujtimin e njerëzve për të mirë. Kështu edhe këta mësues e drejtues shkollë, si edhe shumë e shumë të tjerë kanë hyrë në kujtesën e njerëzve, të malësorëve dhe maleve të Dukagjinit, të cilin do ta ruajnë gjatë, shumë gjatë.

Krishtlindja dhe Viti i Ri po afrohen. Me këtë rast u uroj të gjithëve ta kalojnë të gëzuar edhe të lumtur për shumë e shumë vjet.

Gëzuar!

Luigj SHYTI

Shoqata shqiptare "Shqipëria Ime" - Vareze, feston festat e Nëntorit

Si kurrë ndonjëherë tjetër në ditët e lavdishme të Nëntorit të madh shqiptar, siç do t'i cilësonte njëri nga themeluesit e kësaj shoqate, emigracioni shqiptar në Varese-Itali e ndjeu veten më të plotë dhe më solemn se kurrë brenda vetes: Kjo, sepse, në gjithë domethënien e tij, ky nëntor i festave të mëdha kombëtare solli evenimentin më elegant në jetën e komunitetit që ajo përfaqëson: Promovimin e të parës shoqatë në këtë dhë të huaj, shoqatën "Shqipëria Ime". Dhe kjo, aspak rastësisht, për cilindo që njeh rrugëtimin e dhimbshëm të popullit tonë liridashës dhe mik me miqtë e vërtetë që në zanafillën e historisë së tij dhe deri në ditët tona duke u ballafaquar si pakkush me konsekuencat tragjike të shtjetërsimit në emër të mbijetesës së vet si një komb i vogël.

Një popull i vogël nga më të lashtit në Evropë duke nxjerrë nga gjiri i tij bij të kalibrit botëror si Heroi ynë kombëtar, Gjergj Kastrioti, kryekalorësi i shekullit të vet, mbrojtësi më ekselent i Evropës, ndryshe kryesfidanti i njëres prej perandorive më të fuqishme të globit siç qe ajo osmane, nuk mund të mos ushqente xhelozinë dhe smirën e popujve të tjerë, sidomos të fqinjëve tanë, rrjedhojë e të cilave do të zhvilloheshin si hurdhuri urrejtje dhe përbuzje raciste ndaj shqiptarëve, emigrantëve si të tillë, kudo në kontinent duke i konsideruar të paarrirë, të frikshëm dhe barbarë, që s'njohin jetën në komunitet, ndryshe bashkëjetesën civile me të tjerët.

Ja pra, aspak rastësisht, por krenarë dhe me solemnitet të plotë si bij të tokës së tyre të dashur, Shqipërisë bashkëkohore, anëtare e NATO-s, po aq si investues modernë për ndërtimin e vetvetes dhe të Evropës së Re, janë mbledhur të rinj e të reja emigrantë nga e gjithë Shqipëria Natyrore, së bashku edhe me autoritetet lokale italiane, në promovimin e shoqatës së tyre më të re në moshë dhe më të parën si të tillë, shoqatës "Shqipëria Ime", si dhe për festimin e 28 Nëntorit 2013, Ditës së Pavarësisë, në Hotelin prestigjioz "ATA Hotel"-Vareze, si qytetarë dinjitozë të atdheut tyre, po aq edhe të Evropës së Re.

Kështu, nën tingujt e Himnit tonë Kombëtar, në prani të mbi 500 emigrantëve të ardhur enkas për të nderuar së bashku këto dy evente do të ngrëjë siparin e vet kjo Ditë e Madhe festive-Dita e Flamurit dhe e promovimit të shoqatës së tyre "Shqipëria Ime" me president djalin nga Presheva, Bashkim Sejdiu.

Në ballin e sallës kanë zënë vendet e nderit organizatorët e këtyre festimeve, presidenti Bashkim Sejdiu dhe zëvendës presidenti Rezart Ujkaj së bashku me të ftuarit, autoritetet lokale italiane, përfaqësues të komunës Varese, Giuseppe Montabetti.

Dimensionet e gëzimit dhe begatisë së festës sa promovuese, sa kombëtare sikur i kanë rritur edhe pjesëmarrja e disa shoqatave mike si "Dora e Pajtitimit", "Ura e Bashkimit" dhe shoqata "Nord

& Sud". Entuziazmin dhe hovin festiv e ridimensionojnë jashtë mase prania e këngëtareve shqiptare, aq të mirënjohura në mbare trojet tona, Vida Kunora dhe Rovena Stefa. Mes entuziazmit festiv dhe atmosferës së shkëlqyer festive znj. Luella Hasanaj, prezantuesja e programit i jep fjalën Zëvendës-presidentit të shoqatës "Shqipëria Ime" zotit. Rezart Ujkaj, diplomati i pritshëm shqiptar, në sesionin e fundit të masterit profesional për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Ekonomi Politike, njëherish edhe ish-presidenti i parë i huaj i Shoqatës së Studenteve të Vareses dhe Provincave. "Shoqata jonë erdhi në jetë si zëri i vullnetit tonë të përbashkët për t'u përfaqësuar, si kurrë ndonjëherë më parë, më të plotë, më të pranueshëm, më civilë dhe të integruar si zëri i komunitetit shqiptar në Italinë moderne, në Evropën e Re-theksoi Ujkaj. Kam bindje kategorike se po aq sa unë, edhe secili prej jush, nuk ka se si të mos ndjehet i lumtur dhe krenar për këto dy momente fatlume që po përjetojmë së bashku dhe me kaq solemnitet madhështor në këtë mbrëmje festive, të pashoqen në jetë tonë si emigrantë përkrah shokëve dhe miqve tanë italianë, me të cilët na lidhi epoka e re e hapjes, e dialogut dhe e investimit reciprok për ndërtimin e një Shqipërie të Re, por po aq edhe të një Italie krejt ndryshe nga ajo që njihim respektivisht dhe reciprokisht para këtyre dy dekadave.

Jo pa qëllim zgjodhëm si muajin tonë festiv-promovues nëntorin, Nëntorin e madh shqiptar, Nëntorin e festave tona të Pavarësisë dhe të Çlirimit. Gjithçka, me synimin fisnik, për të ndarë së bashku me ju këtë solemnitet festiv si vëllezër. Zgjodhëm kështu, sepse gjithëherë e gjithësesi nëntori ka qenë dhe mbetet mes nesh si muaji më i rëndësishëm, apo si vetë historia jonë si shtet me themelet e saj. Siç dihet Nëntoriada e lavdishme shqiptare hapi siparin e vet me 28 Nëntor 1443, kur Skënderbeu ynë i lavdishëm, sa vetë shekulli i tij, ngriti mbi kështjellën e Krujës flamurin tonë kombëtar, më i vjetri në Ballkan, ndër më të bukurit në botë, me shkabën dykrenore dhe ngjyrat kuq e zi duke konfirmuar botërisht se shqiptarët nuk e njohin më autoritetin e Perandorisë Osmane mbi trojet shqiptare.

Nëntorin e Dytë shqiptar do ta shënonte diplomati i nivelit evropian e më gjerë, Plaku i Vlorës, diplomati i shquar Ismail Qemali, njohës i shkëlqyer i 6 gjuhëve, ndër politikanët më autoritarë në Per-

andorinë Osmane, i cili pas një itinerari udhëtimi prej 4122 km nga Stambolli, Konstanca, Vjena etj deri në Vlorë do të arrinte të shënonte në historinë tonë kombëtare 28 Nëntorin 1912 në emër të të gjitha trojeve shqiptare, pavarësisht nga gjeografia modeste e shtrirjes reale të pushtetit të tij duke ngritur shtetin e parë, modern, shqiptar. Ndërsa më 29 Nëntor 1944, Ushtria Antifashiste Nacionalçlirimtare Shqiptare, pjesë e koalicionit antifashist, botëror, SHBA-Angli-Bashkimi Sovjetik, do të kthente pavarësinë e humbur më 7 prill 1939 duke e futur përfundimisht Shqipërinë në hartën e botës, edhe pse vetëm në kufijtë e 1913-ës të vendosur nga Fuqitë e Mëdha. Gjitha këto na japim të drejtën morale që të pohojmë me solemnitet se edhe shoqata jonë gjeti ditën më të lavdishme të promovimit: Nëntorin e madh shqiptar, këtë 28 Nëntor që po festojmë sonte. Sado larg atdheut, sa po shohim simbolet tona, apo shijojmë kulturën tonë: Këngët, vallet, historinë dhe traditën tonë ne ndjehemi krenarë, se jemi shqiptarë: Të tillë

dit tim. Duke vlerësuar rëndësinë e këtij eventit për integrimin e mëtejshëm po aq sa mes vetë shqiptarëve dhe me komunitetin pritës italian, ai theksoi faktin "një shoqatë e tillë ndihmon fuqishëm në zhvillimin e jetës sonë sa politike, sa ekonomike dhe kulturore në dobi të dy vendeve tona mike".

Fjalën mbyllëse e mbajti Bashkim Sejdiu, presidenti i shoqatës "Shqipëria Ime" në fjalë e tij insistoi substancialisht në disa aspekte nga më domethënësit lidhur me raportin emigrantë-vendas, si komunitet pritës.

"Ne shqiptarët, të organizuar në këtë shoqatë, -nënvizoi Sejdiu-, duam ti tregojmë te gjithëve qe shqiptari nuk është ai i etiketuari zi dhe më zi nga ata që kurrë s'i deshën të mirën as shqiptarëve, por po aq as suksesit të marrëdhënieve mes dy vendeve tona. Sot shqiptarët janë, jo vetëm familjarë shembullorë, qytetarë të denjë, por kryesorja edhe investues shembullor në ndërtimin e jetës së tyre në Atdheun mëmë, por po aq edhe në Italinë mike. Madje nuk ka fushë, ku sot, këtu ku ne jetojmë dhe investohemi prej mbi dy dekadash së shqiptarët të mos shquhen me civilizimin, komunikimin dhe investimin e tyre shembullor. Ne jemi, jo vetëm te punësuar, por të aftë si sipërmarrës të zotë.

Ky status i ri me jep të drejtën të rritim pretendimet tona legjitime që institucionet lokale në Itali të ofrojnë hapësira për përfaqësuesit tanë në këshillat komunale dhe, përgjithësisht, në institucionet e tyre, si administratorë të zotë dhe menaxhues seriozë vlerash për ndërtimin e jetës së tyre, po aq edhe të Italisë së ditëve tona. Ne jemi gati tani fjalën e keni ju!" përfundoi fjalën e tij, Sejdiu. Pastaj të pranishmit vazhduan me këngë dhe valle sa bashkëkohore, sa tradicionale. Ra në sy përshëndetja, me këtë rast, me një performancë nga vullnetaret e shoqatës "Dora e Pajtitimit", si dhe përshëndetja nga kërcimtarët e shoqatës "Ura e Bashkimit". Nën tingujt muzikorë, gjithë elokuencë dhe ritëm të pranishmit shijuan interpretimet e këngëtareve Vida Kunora dhe Rovena Stefa. Në fund për të pranishmit u preta gjigante kushtuar kësaj festa të madhe. Është për t'u shënuar jehona e madhe që pati kjo veprimtari sa patriotike, po aq civile dhe qytetare e shoqatës "Shqipëria Ime" në mediat italiane vizive dhe të shkruara.

Shoqata "Shqipëria Ime", Varese-Itali, më 29 nëntor 2013



Përshëndetje themelimit të Shoqatës Patriotike “Malësia e Madhe-Nderi i Kombit”

I nderuar Presidenti i Shoqatës Patriotike “Malësia e Madhe-Nderi i Kombit”, Sytqi Ndreca!

Të nderuar anëtare të Shoqatës Patriotike “Malësia e Madhe-Nderi i Kombit”!

Kënaqësi e veçante, të përshëndes, në emër të Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”, Themelimit të Shoqatës Patriotike “Malësia e Madhe-Nderi i Kombit”

Shoqata e jone, në përgjithësi në të gjitha veprimtaritë e saj, ka pasur prezent personalitete të Malësisë, madje edhe nga pjesa që ndodhet në Republikën e Malit të Zi, apo në Republikën e Kosovës, siç janë Ansambli “Dede Gjon Luli”, dega e Shoqatës vëllazërore Kosove-Malësi “Martin Dreshaj”, me qendër në Tuz, Manifestim tradicional-Letrare në Rrozhaj, ansambli “Majat e Karafilave”, në Plave, Shoqata “Martin Dreshaj” me qendër në Peje e deri në Kosovën Lindore, e të tjerë; Kritiku i letrave shqipe, Kadri Ujken, TV “Kopliku”, në veçanti gazetari i tij, Gëzim Vuçaj, studiuesin Ndue Bacaj, drejtorin e revistës “Albdreams.net”, Rush Dragun, e të tjerë, të cilët i kemi pas dhe do ti kemi miq të përherëshëm. Pra, nuk na ka munguar mendja e kontributi i juaj, në realizimin e misionit tone. Për këtë, ju falënderojmë dhe ju jemi mirënjohës!

Tani, është diçka ndryshe. Bashkëpunimi është krejt ndryshe, do të jete në mes të dy shoqatave dhe patjetër kontributi i ndërsjelle do të jete më i gjere dhe më i plote në realizimin e misionit tone të përshëndes. Për këtë, do të keni mbështetjen tone të pa kursyer në realizimin e misionit tuaj, ashtu siç jemi të sigurte se, do të kemi mbështetjen tuaj në realizimin e misionit tone. Kjo mbështetje e ndërsjelle është historike dhe duke qene e tille, ajo edhe në këtë kohe, në kohen e shoqërisë së hapur, në themel të cilës janë vlerat e individit, do të jete më e forte, do te jete me kontribuuese.

Më lejoni të shpreh tre mendim!

Së pari, dy shoqatat tona, kanë një emision të veçante, mision historik, për rrjedhoje duhet të bëjmë përpjekje të mos i politizojmë, në veçanti në përgatitjen dhe zhvillimin e veprimtarive të tyre. Ky do të jete arsyeja kryesore që shoqata të tilla të kenë jetëgjatësi.

Së dyti, te ruhehi nga folklorizmi. Ne, jo në pak raste kemi ndeshur në këtë mendim dhe jo në pak raste na ka penguar ti shohim gjerat drejt e në sy. Ne, mendojmë se ka ikur koha e legjendarëve e dragonjve, e kreshnikeve, të cilët “nuk kane ecur për toke si të gjithë të tjerët”, duke krijuar pengese për të tu arritur ... Ky mendim, na bën të sajojme figura, ngjarje të një shoqërie primitive, e cila kur nuk kishte me çfarë të prezantohet, sajonte. Këto dite lexoj një libër monografik, që e çonte lidhjen e brezit të fisit të vet, me Lek Dukagjinin, çka në të vërtetë nuk kishte asnjë lidhje me dinastinë Dukagjini. Po, kështu, këto dite lexoj një monografi, që çonte brezin te Papa Klementi i XI, çka në të vërtetë nuk ka asnjë lidhje me të paret e këtij Pape. Ne,



nuk kemi nevojë të sajojme, kemi mjaft personalitete të largëta e të afërta në të gjitha fushat e jetës shoqërore, kemi ngjarje të mëdha nacionale, nëpërmjet të cilëve kemi dhënë kontribute të padiskutueshme në themelet e Shqiptarisë, të cilat na bëjnë ta ndiejmë veten krenar në çdo mjedis.

Së treti, të bëjmë përpjekje të mos mbesin peng e së kaluarës. Jo të mos e respektojmë të kaluarën tone, madje të bëjmë përpjekje ti ngremë në vlera të reja, që t'i shërbejnë së ardhmes sonë. Nuk mundet, që të vijojmë të flasim e aq më pak të shkruajmë ende edhe pas katër brezave me një fjalor turqisht, kur ato fjale zëvendësohen më së miri me fjalët e bukura të gjuhës sonë. Nuk mund të ecet ende me nocione të një strukture të kaluar e në veçanti me ato të pushtuesit osman. Strukturën e bajraktarit, për kohen e vet, e respektoj se, me atë strukture janë drejtuar edhe të paret e mi, te paret tuaj, por pasardhësit e tyre, nuk mundet sot, pas katër brezash të prezantohen të tilla. Këto dite, në Miçigan, zhvillohet një Seminar, me teme: “**Hoti ne rrjedhat e shekujve**”. E përgëzova, por nuk munda të rri pa u ndalur, kur në

revistën “Albdreams”, në mes të tjerave, shkruhej: “*Bajraktari i malit të Hotit, Smajl Maliq Çunmulaj, falënderoi panelin, të pranishmit, komisionin dhe sponsorët e kësaj veprimtarie me shumë rendësi, siç theksoi ai ...*”. Personalisht, nuk e njoh, por e uroj të jete, me jete te gjate dhe me nder. Ai, si person, si drejtues i çdo strukture ka të drejte të jete prezent, të thotë fjalën e tij, madje dhe me forcën e statutit të strukturës apo të mjedisit, por në asnjë mënyrë në emër të kësaj strukture administrative të kaluar kohe dhe aq më pak të një pushtuesi, kur sot kemi shtetin demokratik, me strukturat e saj demokratike. Pra, ne duhet të bëjmë përpjekje ti paraprijmë së ardhmes.

Ne, duhet të marrim dituri më shume se, ajo megjithëse ndërton ngadalë, nuk duhet të lejojme, që gjithçka ndërtojmë, injorancën të na i shembi arritjet brenda një kohe të shkurtër, të na shkatërrohet ajo që kemi ndërtuar me aq mund.

Shoqatës Patriotike, Motër- “Malësia e Madhe-Nderi i Kombit”, i urojme, me faqe të bardhe në realizimin e misionit tuaj!

NDUE SANAJ, Kryetari
i Shoqatës “Atdhetare-Dukagjini”

POEZI *** POEZI *** POEZI

Poezi nga Jozef Sokol Progni

O BJESHKËT E DUKAGJINIT

Ne Pranvere kur çel mimoza
dy nder maja rrëshqet bora
neper ara fillon bari e i bie fyellit çobani
qengji i vogël blegërin, fladi i lehte përkëdhel
fyturën njaty i merr bjeshka gjallërimin.

Por kur fillon e rritet
bari plot me shqerra mbushet
livadhi, majat e akujt i përkund era
dielli lëshon rrëzat e arta
nuk e di se çfarë te shikojë përpara.

Te shikoj me përpara ujin e ftohte por si bora
qumështin e deles, porsì mjalti
aromën e luleve si livande
apo njerëzit qe te rrethojnë qe me bujari
te papare te nderojmë.

O ju bjeshkët e Dukagjinit
Porsi petalet e trëndafilut
Nuk ju tremb asgjë ne bote,
por qëndruat si kurore ne koke
përkrenare lum ai qe ju sheh përballë.

Ah moj bjeshkët e Dukagjinit,
sikur te isha unë poet,
sikur te isha unë shkrimtar,
ne çdo proze e poezi,
emrin tënd do te vija te pare.

Sot i vogël, unë jam dhe shume histori te tua-
ja ne sirtar i kam
Po, kur te jap besën, kur te rritem
Edhe unë do ta mbaj traditën
Sa te jem gjalle e do te rroj ty Dukagjin, unë
s' do te harroj.

DUKAGJINI

Dukagjin o shkëmb graniti
çdo rrebesh qe ty te mërzi
vetëm kokën e vet ai përmbysi
Dukagjin o vend legjendash shekullore,
qe te gjithë Ballkani i ka mësua.

Qysh me Leken, princin e pare, qe e njohu
gjithë Evropa mbare,
krahu i dhathte i Gjergj Kastriotit, qe mbajti
besën e flijoj jetën,
qysh atë dite e ne kohen e sotme ty askush
nuk te nënshtroi,
por more pushkën e luftërave për atdhe ti u
flijove.

Asnjëherë o Dukagjin,
s' njohe frike, s' njohe trishtim,
nuk te ndau fe as parti,
por luftove për liri,
për liri e për vatan,
për bese e bujari,
mirë te njohu kjo Shqipëri.

Trimat e tu qe si ka pas as,
bota mbar, me Mark Lula, Mehmet Shpend,
Ndok Gjelosh, Mark Sadiku e Dode Tahiri,
qe e pat njohtë mire Serbia, me Marash De-
liaj,
Deli Pjetra e shume djem te ri, e janë skalit
ne histori.

Dukagjin për ty jam krenar
qe te ka njohtë historia mbare.
e gjithë bota le ta di s'ka Shqipëri pa Dukagjin
s'ka Ballkan pa Shqipëri
s'ka Evrope pa Ballkan
s'ka Bote pa Evrope.

AKTORJA E MADHE E ZYLIHA MILOTI, NJË NDËR IKONAT E HUMORIT SHQIPTAR

Nga RAMAZAN ÇEKA,
poet popullor

Mëngjeset e bukura me diell, gjallërohen çdo ditë në qytetin e Shkodrës, nga lëvizja sa tradicionale edhe bashkëkohore, e mjeteve që nuk nxjerrin tym dhe që nuk bëjnë zhurmë. Këto janë biçikletat. E në një nga këto biçikleta, në lagjen e vjetër Perash, çdo ditë mund të shikosh një personazh të njohur, që përshëndetjet e banorëve e shoqërojnë deri tek tempulli i teatrit "Migjeni" ku ajo hyri shumë e re dhe jetoj si të ishte shtëpia saj e dytë. Kjo është aktorja e madhe e humorit shkodran dhe atij shqiptar: Zyliha Miloti.

Pa i mbushur 14 vjet, kur ishte në klasën e 7-të, ajo u paraqit për herë të parë para publikut si një këngëtare e vogël shumë e talentuar. Rolet e para kanë qenë dramatike dhe si aktore e humorit ajo i filloj në moshën 20 vjeçare në estradën profesioniste të qytetit të Shkodrës pranë teatrit "Migjeni".

Shkodra është quajtur dhe e quajné ende "Djep i kulturës dhe i qytetërimit", ky djep ka përkundur kaq e kaq emra kolosësh. Një ndër këto emra është edhe aktorja e mirënjohur e humorit, Zyliha Miloti.

E paarritshme në skenë, gjithmonë e respektuar dhe modeste. Me qindra role në karrierën e saj të shkëlqyer.

Galeria e personazheve që krijoi dhe eksperiencia e saj, bënë që ajo të mbetet një nga aktoret e shquara në skenën e humorit shqiptar.

Zyli është sinonim i estradës, aktorja e të gjitha planeve, një grua fisnike, plot elegancë dhe mjaft komunikuese. Fjala e mirë është në fillësën e çdo fjalie të saj. Ajo gjithmonë u paraqit denjësisht, ashtu si e kanë njohur në vite shqiptarët në skenë, ekran, radio, intervista, apo krijimtari: e thjeshtë, elegante, krenare, e sinqertë, pa teprime, një grua e vërtetë shqiptare, me të cilën Shkodra krenohet.

Një gjysmë shekulli karrierë artistike në Teatrin e Estradës dhe gjatë këtyre viteve ka realizuar më shumë se 250 premiera shfaqje. Në çdo premierë rolet e saj kanë spikatur për interpretim të shkëlqyer dhe kanë qenë të arritura. Përveç këtyre ajo ka marrë pjesë në teatrin e dramës dhe në një numër të madh filmash të kinostudios "Shqipëria e re" dhe të atyre pas viteve '90.

Gjithë jetën e saj pa u larguar asnjë ditë nga kjo estradë e që prej vitit 1967 ajo ka interpretuar plot gjallëri në shfaqjet e planifikuara të asaj kohe në fshat, malësi si dhe në të gjithë Shqipërinë.

Edhe pse ndodhen ndryshimet, ekso-di, lëvizje demografike, ajo nuk u largua nga Shkodra për asnjë ditë. Një jetë të mbushur me role dhe ngjarje nga më të bukurat, me role të plota, asnjëherë nuk është lënë në prapavijë. Zyliha Miloti është një artiste me botë të pasur shpirtërore, në interpretimin e së cilës rrjedh natyrshëm humorit shkodran. Një aktore e mrekullueshme me një intuitë improvizuese. Ajo është produkt i një vo-



kacioni hyjnor për t'u ndjerë në skenë si në shtëpinë e vet. Zyliha Miloti është shikuar gjithmonë me admirim për energjinë dhe fisnikërinë që përcjell kjo artiste e madhe me vlera të rralla dhe me një karrierë të përsosur. Një artiste e jashtëzakonshme dhe e pazëvendësueshme, e sinqertë, e qeshur, plot optimizëm dhe unike, ajo la gjurmë me jetën e saj artistike, në historinë e teatrit dhe filmit shqiptar.

Zyliha Miloti ka pasur fatin e madh që ka punuar me një plejadë artistësh të mëdhenj, regjisor e shkrimtarë në estradën profesioniste të qytetit të Shkodrës pranë teatrit "Migjeni". Ajo gjeti një grup aktorësh të paarritshëm.

Ka qenë regjisor i ndjeri Paulin Sekuj i cili ka punuar për një kohë të gjatë me Zylin, pastaj kanë vazhduar të tjerë regjisor të mëdhenj si: Serafin Fanko, Etmond Mhilli, Gjergj Vlasi, Haxhi Rama, Fatbardh Smaja, Bruno Shllaku e te tjerë. si dhe shkrimtarët Fadil Kraja, Paulin Selimi, Koleç Pepa, Stefan Çapaliku e të tjerë, që kohët e fundit janë përfaqësuar denjësisht me Zylin.

Puna me këto artistë të mëdhenj ka qenë për Zylin një akademi e madhe arti, duke qenë vazhdimisht në krah të tyre, ajo arriti që me talentin e saj të rrallë, me përkushtim e pasion të arrijë majat e profesionalizmit dhe sot respektohet nga të gjithë, duke i dhuruar asaj duartrokitje dhe mirënjohje. Nuk harrohet dyshja e humorit Tano Banushi-Zyliha Miloti, për 25 vite me radhë dhe më vonë me aktorin Paulin Preka që janë padyshim maja e estradës shqiptare.

Qindra role ka interpretuar Zyli edhe me aktorë të tjerë, duke pasur materiale letrare të jashtëzakonshëm, me të vërtetë secili më i mirë se tjetri.

Nuk harrohet kurrë autori i pashtershëm i burimit të këtij materiali letrar shkrimtari humorist, i ndjeri Paulin Selimi, cikli i parodive me Gjoshë Vasinë, apo kupletet dhe paroditë e spikatura me aktorin, humoristin e shquar Zef Deda.

Në plejadën e mrekullueshme të aktorëve ka qenë edhe i paharrueshmi Hasan Smaja (Artist i merituar), Bik Pepa, si dhe aktorët e një brezi më të ri, Zef Deda, Besnik Çinari, Jolanda Shala, Katrina Biga, Drande Xhaj, Gëzim Kruja, Smajl Alia, Sandër Ruçi, Anton Krosaj, Muhamet Çekini etj. Talenti dhe aftësia

profesionale e Zylit, sigurisht që ka bërë të jetë e përshtatshme për këta aktor, duke punuar me një dëshirë e pasion të madh me të cilët sukseset kanë qenë gjithmonë të garantuar.

Zyliha Miloti ka qenë gjithmonë shumë energjike në rolet që ajo ka interpretuar me kaq siguri dhe madhësi, jo vetëm në estradë por edhe në dramë e komedi, pa harruar pjesëmarrjen e saj në filma, opereta etj. Ajo vazhdon të jetë aktive edhe sot në veprimtaritë artistike të teatrit "Migjeni", duke sjellë gjithmonë një zë të veçantë, një aktore shumë cilësore, me një jetë artistike të mbushur me suksese pas suksesesh, me rregulla dhe kërkesa të larta, sidomos përsa i përket përmbajtjes së skeçeve. Gjithçka kalon në vrimë të gjilpërës, shumë bukur dhe me fjalë inteligjente, humor të zgjedhur dhe një dialog plot finesë. Ajo është specialiste e skenës dhe i ka dhënë shumë artit shqiptar.

Estrada e Shkodrës gjithmonë i ka paraprirë humorit shqiptar. Pa kontributin e estradës së Shkodrës, nata e vitit të ri as nuk është menduar të realizohet në RTSH. Në estradën e Tiranës ka pas një thënie që kur do të vërtetosh se sa humor ka shfaqja, shko në Shkodër dhe po të vlerësuan aty shfaqja është në rregull. Ky është treguesi më i saktë sepse barometri matës është vetë publiku shkodran.

Zyliha Miloti ka interpretuar në shfaqjet e saj edhe jashtë kufijve të atdheut, në zona shqiptare dhe në diasporë, ku është pritur jashtëzakonisht mirë, duke pasur në krah aktorin e madh, artistin e merituar Paulin Preka dhe më pas me aktorin e talentuar Besnik Çinari dhe me një grup nga Shqipëria, aktorët e estradës së qytetit të Durrësit Muharrem Hoxha dhe Roland Koçi, në Toronto (Kanada), ku patën një sukses të jashtëzakonshëm. Po ashtu disa herë ka qenë edhe në SH. B. A. ku edhe atje është pritur jashtëzakonisht mirë dhe me emocione shumë të mëdha.

Në vazhden e disa komedive veçohet "Surpriza" e shkrimtarit dhe dramaturgut të famshëm, Fadil Kraja, si dhe "O vajzën, o komunën", "Vëllai nga babai", të shkrimtarit Qazim Çela.

Është pasioni dhe dëshira e madhe, dashuria që Zyli ka për vendin dhe qytetin e Shkodrës që sot interpreton me aq freski dhe me një humor që jo vetëm buron nga shpirti i saj, por ky humor është një pus i thellë që nuk shteron për asnjë stinë të vitit. Ajo vazhdon të bashkëpunojë në mënyrë aktive edhe sot e kësaj dite me aktorët e mëdhenj, Zef Deda e Besnik Çinari, dhe me një brez më të ri që Shkodrës nuk i mungon kurrë. Ky bashkëpunim solli edhe suksesin e shfaqjes "Bik brother 1" të shkruar nga regjisorin Arjan Çuliqi në të cilën ishte regjisor edhe Fatbardh Smaja, si dhe "Bik brother 2" po me regjisorin Arjan Çuliqi, të shkruar me bashkautorin Besnik Çinari, që teatrit "Migjeni" i kthyen kohët e bukura, kur ishte vështirë të gjeje një biletë.

Zyliha Miloti ka luajtur në shumë shfaqje teatrale, por disa kanë mbetur si

një identitet i saj, duke e thirrur me emrat e roleve siç janë: Hana, Rabija, Zade, Luli, dhe Lokja me të cilën ajo përfaqësohet për herë të dytë duke realizuar një tjetër figurë të Lokës: një nënë kosovare e cila në luftën për çlirimin e Kosovës, pasi përcjellë për në U. Ç. K., 9 djemtë e saj së bashku me vajzën e vetme, duke iu dhënë bekimin e saj si nënë, mbas pak çastesh i rrethohet kulla me ushtarë serb. Momente të vështira për një plakë të vetme por trimëshë që nuk mposhtet para tyre. Emocione të mëdha, përlotje në përcjellje të fëmijëve dhe barbari nga ana e serbëve deri në qorrim të syve. Megjithatë Lokja ndihet e lumtur që nuk i shikon më këta barbarë. Këtë figurë ajo e realizoi me shumë vërtetësi në videoklipin e një kënge kushtuar heroizmit të nënave kosovare gjatë kësaj lufte. Ajo mishëron artistikisht atë që ka krijuar në tekstin e këngës autori i saj Gjovalin Dushaj, i njohur si një autor me vlera në planin artistik e patriotik, si dhe interpretimin e shkëlqyer të këngëtarit të talentuar Pëllumb Vrinca.

Këto ditë ka filluar punën për të vënë në skenë një komedi të shkrimtarit Fadil Kraja "Martesë me internet", me regjisor Bruno Shllaku, ku rolin kryesorë si gjithmonë e interpreton Zyli, në rolin e "Anës".

Në bisedat me Zylin, duke shijuar një kafe, duke diskutuar për tema të ndryshme, por në mënyrë të veçantë për jetën artistike, ajo shpesh kthehet prapa në kujtime dhe përmend me nostalgji kohën kur ajo interpretonte në skenën e teatrit me aktorët e paharruar Tano Banushi, Hasan Smaja, Bik Pepa, Jolanda Shala e te tjerë.

Shkrimtari dhe dramaturgu i madh Prof. Fadil Kraja thotë për Zyliha Milotin: "Në çdo teatër shkojnë dhe vijnë shumë aktorë, regjisorë, autorë apo scenograf, shumica dërrmuese e tyre, me kalimin e kohës harrohen, fshihen nga kujtesa, sepse nuk lënë gjurmë. Të pakët, shumë të pakët janë ata që kujtohen dhe i qëndrojnë kohës dhe ndërtojnë, apo shkruajnë historinë e çdo teatri, kudo që interpretojnë. Në teatrin "Migjeni" të Shkodrës, Zyliha Miloti është një aktore e tillë, pjesë e rëndësishme në historinë e këtij teatri gjurmëlënës. Aktore potente, me një patos të lakmueshëm, me individualitet, me sharmë...jo vetëm në shtratin e humorit e të satirës ku shkëlqen gjithashtu, mjeshtërisht. Talente të tillë si Zyli janë fat për një teatër, sepse vinë rrallë. Ata nuk kanë moshë. Në kujtesën e spektatorit ata mbeten të rinj e të freskët përjetësisht".

Në një bisedë me artistin e mirënjohur regjisorin dhe karikaturistin Bujar Kapexhiu morëm këto vlerësime: "Zyliha Miloti mendoj se është ndër aktoret më të mira të humorit shqiptar në përgjithësi, jo vetëm në interpretimin e karaktereve, por njëkohësisht në improvizimin dhe theksin e batutës humoristike me një plastikë të përsosur dhe mbi të gjitha me një lirshmëri në lëvizjet në skenë. Kam

RAPORTAZH NGA TROJET SHQIPETARE NË MAL TË ZI

Nuk është aspak për tu habitur kur kalon nga Shqipëria për në trojet Shqiptare në Mal të Zi. Sapo hynë në pikën e kalimit kufitar, normalisht të kërkojnë dokumentet, menjëherë mendja të shkon te absurditeti. Po sikur të kërkojnë dokumentet për të udhëtuar nga Lezha për në Shkodër. E njëjta gjë është të shkosh nga Shkodra për në Tuz, Ulqin e te tjere. Themi se, e njëjta gjë është për në Maqedoni se me Kosovën gjërat po shkojnë mire. Më e rëndë gjendja është të udhëtosh nga Presheva, Metvegja e Bujanovci për në Kosovë, pasi për banorët e këtyre Komunave për me hy në Kosovë për veç dokumenteve, ata duhet të paguajnë edhe taksë. Duhet përsëritur vendimi i Qeverisë së Kosovës për të hequr taksat në hyrje e dalje për shqiptaret e këtyre komunave. Por mendimet udhëtojnë me shpejtësinë e dritës. Pa drejtësinë e bëra para 100 vjetësh ndaj shqiptarëve nuk mund të riparohen lehtë.

Le të kthehemi te qëllimi i këtij shkrimi, i cili bënë fjalë për qëndrimin disa ditë në Tuz, Plavë e Guci. Ndonëse janë shpallur komuna ata kanë të drejta të kufizuara, pra shumë më pak kompetenca se sa komunat e tjera në këtë shtet. Me gjithë atë njerëzit ambientohen dhe jetojnë, punojnë me biznese se punësimi në shtet është i kufizuar për shqiptarët. Madje kjo e të tjera kanë qenë mbase edhe arsye të emigrimit, që po thuhet gjysma e shqiptarëve, jetojnë në SHBA e në Perëndim. Pavarësisht presioneve të bëra, përsëri ata nuk ja kanë arrit qëllimit, sepse ata ruajnë traditat e zakonte më me fanatizëm se ne. Të bie në sy mbiemrat, të cilëve ju kanë shtuar prapshitesat siç janë: Vuksan-Vuksanoviç, Selim-Selimoviç e te tjere. Në sy të bije se në Rozhaje vetëm moshat e vjetra e flisnin gjuhën shqipe, të rinte, madje e mohonin edhe kombësinë shqiptare. Nuk bëhej fjalë për shkolla shqipe. Ndërsa në Plavë e Guci, ndonëse kishin shkolla shqipe, në markete e në lokale flisnin serbisht!

Plava e Gucia janë perla të natyrës shqiptare, me livadhe e pyje mahnitëse, bukurinë më shumë ja shton liqeni me të njëjtën emër, ku rriten lloj-lloj peshqish, por më shumë trofta. Ndërtesat ishin dy e tre kate, kuptohet të stilit alpin, por nuk kishin rrethim, madje as hekura në dritare. Toka të sistemuara, kopshte me lloj-lloje pemësh. Të gjitha të pa rrethuara. Kjo vërteton se atje pronën e qytetareve e mbron shteti.

Megjithëse kishte pak banor se, vetëm në verë ajo popullohej. Emigrantet vinin kryesisht nga Amerika, por edhe nga Evropa, për të kaluar pushimet aty. Sa here që kalojë në këto zona, si Plava e Gucia, Rugova e te tjera, më ngjallin kënaqësi se, ngjajnë me vendlindjen time, me Thethin, i cili me bukruite që i ka falur Zoti, jua kalon te gjithave. Jo se them unë, e thonë gjithë ata që kanë vizituar Thethin. Më ka mbet në mendje thënia e gazetares së mirënjohure Rudina Xhunga se, Thethi është kryevepër e natyrës shqiptare. Fola për Thethin se, kur vizitova Rugovën e Gucinë thashë se, atë që nuk jua ka dhënë natyra, jua paska dhënë njeriu, me infrastrukturë, energji elektrike e me ujë të pijshëm. Këto avantazhe i kishin të gjitha shtëpitë, pamvaresisht se, distanca e shtëpive nga njëra tjetra ishte deri në 2 km.

Mendja më shkante te vendlindja e ime Thethi, që vuan për infrastrukturën, energjinë elektrike e ujin e pijshëm e te tjera. Në 24 km rrugë nuk ka vënë kush dorë që nga ndërtimi i sajë në vitin 1936, ndonëse në Theth është ndërtuar hidrocentrali i pare në Veri, sot ata vuajnë për energjinë elektrike, megjithëse në Theth ka mbi 100 vend burime uji dhe përsëri mungon në familje. Ka pasur çerdhe, kopshte e shkollë të mesme. Tani janë katandisur si mos më keq. Zanafilla e gjithë këtyre është mungesa e infrastrukturës rrugore. Megjithatë vitet e fundit ka përmirësime, si në ndërtime bujtinash e hotelesh, por akoma janë shumë larg vendeve të citu-

ara më lartë.

Në Rugovë banoret ishin me origjinë Kelmendas, të cilën e shprehnin me mburrje. Po kalove andej të bie në sy një kishë e ndërtuar kohet e fundit. Ndërtimi i saj ishte bërë mbi rrënojat e një kishë qindra vjeçare. Çudia e madhe ishte se, të gjithë banorët e Rugovës ishin të besimit mysliman. Një banor i quajtur Selim, i cili i kishte kaluar të tetëdhjetat na shpjegojë se, këtu ku është ndërtuar kjo kishë, ka qenë një kishë shumë vjetër, atëherë kur gjithë Rugova ka qenë e besimit katolik. Kisha e re u ndërtua nën kujdesin e ish-presidentit Ibrahim Rugova. Dhe këtu çdo javë vjen prifti e thotë meshë. Në meshë shkojmë edhe ne myslimanet e i lutemi Zotit se, ai është vetëm një për të gjithë njerëzimin. Ka dhjetëra familje që janë kthyer në besimin e vjetër, pra në besimin katolik. Sa kuptim plotë është ndërtimi i këtij objekti kulti, për tu treguar brezave se ne jemi kthyer në mysliman me forcë nga pushtuesit Otoman. Sa çudi do ti kishte ardhur të Presidentit Rugova, sikur të kishte dëgjuar Kryeministrin turk Erdogan, kur tha se Kosova është Turqi.

Gjatë këtij udhëtimit kishte disa eventimente të rëndësishme. Siç ishte ai i dhënies se titullit "Mirënjohje e Komunës Shëngjinit", Piktorit Maester Gjesh Gjo-kaj nga Tuzi i Malit të Zi, i cili mbante me dhjetëra medalje e dekorata nga shumë shtete të Evropës e nga SHBA. Në këtë ceremoni merrnin pjesë biznesmen e figura të shquara të trojeve shqiptare, prej të cileve veçojmë: Rrok Stanaj, Gjokë Cami, profesor Xhelal Nikaj e te tjera. Merrte pjesë Kryetari i Komunës të Podgoricës, Mugosha. Titullin e nderit ja dorëzojë Kryetari i Komunës Shëngjinit, Salvador Kaçaj. Fjalën e mori Maester Gjesh Gjo-kaj, i cili falënderojë Kryetarin e Komunës Shëngjinit për nderin e madh që i behet dhe premtojë se do të hapi një ekspozitë në qytetin e Shëngjinit. Para shumë televizioneve të pranishëm nga Shqipëria e Mali i Zi e mori fjalën Kryetari i Komunës së Podgoricës, Mugosh, i cili tha: "Jam shumë i gëzuar që marrë pjesë në këtë eventiment të rëndësishëm që i bëhet piktorit e maestrin Gjesh Gjo-kaj. Foli me super relative për Shqiptaret, për bashkëpunimin me ta. Në mes të tjerave ai tha se origjinën e hershme unë e kam nga Shq-

ipëria dhe pikërisht nga Durrësi. Për nder të pranishmeve u shtrua një darke në lokalit "Senishta"

Eventiment tjetër ishte ai i organizuar në Guci, me rastin e dhënies titullit të "Mirënjohje e Komunës Shëngjinit", Ndue Mark Vuksanaj, me motivacionin "Për qëndrim të pa lëkundur ndaj regjimit komunist", regjim, i cili i kishte pushkatuar pa gjyq babanë dhe tre axhët e tij, ne moshën nga 20 deri në 50 vjeç. Nanen e motrën ja internuan në kampin famëkeq të Tepelenës, ndërsa Ndoja në moshën 13 vjeç arratiset duke udhëtuar tre ditë në këmbë, neper male e më në fund ka arrite në Jugosllavi. Titullin ja dorëzojë Kryetari i Komunës Shëngjinit, Salvador Kaçaj. Z. Ndue, falënderojë Komunën e Shëngjinit dhe kryetarin Kaçaj, për nderin e madh që i behet. Ai, u zotua se ashtu siç kam punuar do punojë me djemtë, vajzat, nipër e mbesa për të mbajtur lart emrin e shqiptarit, kjo ka qenë motoja e jona vazhdimisht. Ne, biznesin e kemi ndërtuar me djerse e ndershmëri.

Me këtë rast u organizua një darkë në restorant "Ujka", ku merrnin pjesë autoritete vendore, biznesmen e te tjerë. Ndodhesh edhe biznesmeni Pëllumb Boshi. Të nesërmen ne, vizituam zonat me të spikatura me vlera historike. Në mes tjerave, shkuam edhe në Zeletin. Kjo e fundit më ngjalli një ndjesi shumë të hershme. Kur babai im, i quajtur Nikoll Gjergj Ziçi, tregonte se si në kulmin e dimrit kanë luftuar kundër çetnikeve për mbrojtjen e Plavës e Gucisë. Vuajtjet dhe luftimet e ashpra të zhvilluara për të mbrojtur trojet shqiptare, të cilat drejtoheshin nga Prekë Cali. Ndonëse i vogël isha, kur dëgjoja bisedat për luftimet e zhvilluara, për heroizmat e këtyre burrave, sakrificat deri edhe më sublimet, pra duke dhënë jetën. Me dhjetëra ishin ata që nuk u kthyen më, duke rënë në fushën e betejës. Biseda të cilat më ngjallnin një urrejtje për armiqet, njëherazi edhe dashuri e krenari për trojet shqiptare. Kontributet e dhëna, e heroizmat e këtyre burrave të malësisë i mbeten historisë e historianeve për ta ndriçuar akoma më mire.

Bera perpjekje të sjell për lexuesin disa aspekte nga zonat shqiptare, emocione, mbresa dhe mrekulli te tyre.

Ndue Ziçi

pasur fatin që ajo ka interpretuar në filmin tim "Dy herë mat" duke i shtuar vlerat e autorit dhe regjisorit. Janë talente që rrallë i vijnë skenës dhe filmit shqiptar".

Besnik Çinari, një ndër partnerët më të spikatur të Zylit, pa dyshim vlerësimet e t'ia i shpreh me ngjyra humorit: "Zyliha Miloti është një ndër aktoret e shquara në të gjitha kohërat në Shqipëri. Është fat i madh për mua me interpretua në skenë krahas saj, këtu e 32 vjet më parë, e fat më i madh që rreth 20 vjet të jesh si një partner".

Regjisori i teatrit "Migjeni" Fatbardh Smaja rrëfen me respekt për Zylin: "Është një aktore e kompletuar. Ajo interpreton në mënyrë të jashtëzakonshme. Gjithmonë ka pasur diçka të veçantë në ndërtimin e figurave artistike në botën e personazhit. Gjithmonë përpigjet të shpërndaj mirësi në grup. Dëgjon me shumë vëmendje dhe përpikëri kërkesat e regjisorit".

Ja çfarë thotë Mjeshtri për Mjeshtrën: "Bujar Qamili e vlerëson Zylin si një nga aktoret e humorit dhe komedisë që rrallë mund t'i vij teatrit "Migjeni". Një emër shumë i madh që është e pëlqyeshme në çdo shtëpi shkodrane dhe shqiptare. Emri i Zyliha Milotit është sinonim i teatrit "Migjeni", pa Zylin nuk mund të bëhet humor në skenë. Zyli me madhësinë e saj vazhdon të ecë me biçikletë nëpër Shkodër dhe shpesh qytetarët kur e shikojnë thonë (Si s'po din m'u plakë Zyli).

Zyli është dhe do të mbetet ikonë e humorit shqiptar. Është kënaqësi e madhe për këdo kur është ballë për ballë, sidomos kur pinë një kafe me Zylin".

Zyli është vlerësuar me disa çmime, tituj dhe shpërblime. Artiste e Merituar, "Gruaja e vitit 2000-2001" nga Instituti i Biografive në Kembrixh të Anglisë, duke u zgjedhur mes 2000 personaliteteve botërore. Ka marrë çmim në "Ditët e humorit", pastaj çmimin "Naim Frashri i Artë" me motivacionin "Për kontribut të

shquar në artin skenik dhe interpretim me nivel të lartë në gjininë e humorit": "Mjeshtrë e madhe e skenës", dekoruar nga Presidenti i Republikës, si dhe me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë ju akordua çmimi "Ambasadore e paqes".

Arritjet dhe suksesin e saj Zyli ja dedikon familjes, e në mënyrë të veçantë, burrit të saj, Fatit i cili ka qenë një shok dhe frymëzues për te. Ai ka qenë muzikant në estradë si dhe piktor. Sot Zyliha Miloti ndihet e lumtur, ka një vajzë Aidën në Gjermani, dhe ajo që ja freskon më tepër jetën është mbesa e vogël Lulebora që e donë shumë dhe shpreson që të ketë talent edhe ajo pasi po mëson baterinë, si gjyshi i saj i ndjeri Fuat Miloti. Freskinë dhe lumturinë e jetës Zylit ja shton edhe nipi i saj Drini, i cili edhe ai premtion shumë për një vokal të bukur, e pse jo, kot nuk thonë dardha bie nën dardhë.

Një peng që ka mbetur në karrierën e saj artistike të suksesshme është reduktimi në identifikimin e roleve dramatike,

aftësi e cila nuk është shfrytëzuar sa duhet nga regjisorët e teatrit të dramës. Kjo aftësi u demonstrua edhe në teatrin "Apollonia", në festivalin mbarë kombëtar me teatrin kombëtar, e cila shkëlqej dhe u quajt befasi e festivalit, duke mahnitur publikun dhe duke u vlerësuar si aktorja më e mirë e këtij festivali.

Zyli rrëfen për Shkodren duke thënë se ajo e do shumë qytetin e saj të lindjes dhe se kur largohet dëshiron të kthehet shpejt. Ajo tregon se kur shikon kalanë i mbushen sytë me lot nga malli. Ajo është optimiste se Shkodra është dhe do të mbetet Shkodra, djep arsimit, kulture e sporti, ashtu siç e kanë ndërtuar të parët tanë e siç do ta ruajnë e çojnë më tej, brezat që do të vijnë. Ky fakt, thotë ajo më freskon dhe rinon. Dhe kjo batutë e (thënë) hedhur me humor, siç është vetë natyra dhe karakteri i saj mos t'u duket çudi: Ajo e nget biçikletën nëpër Shkodër si një vajzë e re.

Syndromi acut respirator i rende (SARS)



Pregatiti, Dr. Med. Ndue NIKAJ, Bushat, SHKODER

ALARM në Europe !

SARS-Cov është një sëmundje infektive e re e përshkruar për herë të parë në vitin 2003. SARS-Cov (term Angloamerikan) e shkaktuar nga Corono-viruset agresiv u shfaq rasti i pare i izoluar; ne hotelin Metropol (Hong Kong) dhe me 12 mars 2003 organizata Botrore e Shëndetsis (OMS) leshoi alarmin për rrezikun e epidemisë, por siç u vërtetua më vonë → raste të ngjashme ishin vërtetuar që me 1 Nentor 2002 në Guong – dong (Kinë) por ishin nënvlersuar. Kjo epidemi 1 Nentor 2002 deri 1 Korrik 2003 u përhap në shumë vende të botës ku peshën më të madhe e zune:

Vendi	Raste	Vdekje
Kina	5900	348

Hong – Kong	1654	204
Tajëan	125	11
Kanada	251	44
Singapor	204	27
SHBA	66	0
Vietnam	63	5

Me një numër total 8096 raste dhe 774 vdekje.

Tani pas një dekade (ne Maj 2013) po jepet alarm në Europë ku janë shfaqur raste ne Hollande, Gjermani, France dhe Mbretërin e Bashkuar bile ka patur raste të infektimit të personelit shëndetsor; gjatë manipulimit të këtyre të sëmurve.

Pra corona-viruset po shfaqen me karakteristika të reja që nuk ishin njohur më parë, por në fakt prej kohësh ishin ciluar si shkak i sëmundjeve infektive tek njerzit dhe kafshët. Pjesa më e madhe e ftohjeve (pneumonive atipike) vine nga vete korona-viruset (Cov);

Pavarsisht nga karakteristikat e reja të virulences dhe pathogenitetit te korona-virusit pergjegjes per SARS-Cov. Paraqet te njejtat karakteristika si viruset e tjera si: rezistence e ulur ndaj faktoreve të ambientit të jashtëm, dhe ndjeshmëri ndaj gjithë dezinfektantve.

Dhe ky virus transmetohet me anë të kontaktit direkt me të semurin, me anë të grimcave (sperklave) në pështymës e sekrecioneve të tjera me anë të kollës, teshtitjes si dhe me materialet e të sëmurve në fazën simptomatike, por më pas ambjenti ku qëndron i sëmuri nuk mbetet i infektuar pasi siç paraqit virusi nuk është rezistent dhe i pergjigjet dezinfektimit.

Vdekshmëria midis të kontaktuarve me virusin është 15%.

Në mënyrë të veçantë rrezikohet përs-

oneli shëndetsor i kujdesit dhe te afermit ne fazen simptomatike. Masat me izolimin e të sëmurve dhe të kontakteve kanë dhënë rrezultate në kufizimin e përhapjes së sëmundjes.

Syndromi acut respirator i rende (SARS-Cov_ nga koronaviruset ka nje periudhë të fshehtë para shfaqjes së shenjave prej 2-10 ditë, pastaj kemi temperaturë mbi 38° C, kollë e thatë, herëherë të dridhura (frisone) si dhe shenja të tjera si dhembje koke, muskujsh; keqsim i gjendjes së përgjithshme njëlloj si gripp i zakonshëm. Disa të sëmur shumë shpejt shfaqin shenja të vuajtjes respiratore (frëmëmarrjes), por në shumicën e rasteve turbullimet respiratore shfaqen vonë. Në raste të rralla si në Hong-Kong, ka (të vjel-la, diarhe).

Në venien e diagnozës krahas kuadrit klinik të veçantë dhe situatës epidemilogjike eventuale orjentohe mi në :

Ekzaminimin radjologjik : që zë një vend të rëndësishëm në diagnozën SARS-Cov dhe për ndjekjen e efikasitetit te mjekimit, ku në ro-grafi kemi një lokalozim tipik periferik; errsim të alveolave, pa likid në pleurë (pleurit), pa kaverna; po node hylare.

TAC (skaneri) pulmonar : në përgjithësi vërteton e precizon shenjat e një pneumopatie te rende.

Diagnoza mbeshitet ne evidentimin e viruseve te SARS-Cov në kulturë nga gryka, hemokulture ose copokulturë ose me fluoroshuncë me fiksion të qelizave të infektuara acidi-ribo-nukleik (ARN) e SARS-Cov është zbuluar me RT-PCR te sekrecioneve nazo-faringeale ne 32% në stadin fillestar dhe 68% pas 14 ditësh (Peiris, Lancet,2003)

Diagnoza serologjike na ndihmon ne

rikonsiderimin e rasteve te pneumopathis së pa identifikuar si testi ELISA për IgG dhe IgM paraqet detaje pas ditës së 21 të fillimit te sëmundjes. Dhe me imunofluoroshencë IgG dhe IgM gjenden te ritura pas ditës 10-te.

Analiza e gjakut (hemograma) tregon leukopeni me linfopeni ne 98% të rasteve, gje e cila rivendoset pas tre javesh, po ashtu dhe trombocitopeni leukocitozë. Në fazën fillestare niveli i lifociteve CD4 dhe CD+8 mund të jetë shenjë e një prognozë të rezervuar.

Po ashtu kemi rritje të fermenteve : LDH, të transaminazave SGPT? ALAT dhe Kretinim-kinazës, që ndodh kur perdoret RIBAVIRINA ose hyperleukocitoza kur perdoret KORTIZONI në detresin respirator. Por rritja e ketyre tregusve biologjik si LDH, Transaminaza ose limpofeni me ulje te CD-4; CD-8 duket se flet per prognozë të rezervuar.

Përsa i takon trajtimin të SARS-Cov nuk disponohen preparate antivirale, por vazhdohet mjekim simptomatik. Dhe RIBAVIRINA, që u përdor në 2003 ka dhënë shumë efekte ansore deri të rënda. Antibiotiket mund të përdoren veç për shkaqe bakteriale të pneumopatis kur nuk kemi një diagnozë preçize.

Duhet të mbahet me oksigjen (0-2 terapi) me frymemarje te drejtuar ne reparite te reanimacionit; ne rastet e dystresit respirator me hypoxemi dhe tendence kolapsi duhet perdorur kortikoterapi. Pra të sëmuret duhet të izoloohen; personeli shëndetsor duhet te mbrohet me veshje speciale dhe maska duke rritur vigjilencën; kohët e fundit po flitet per nje vaksine e cila eshte ne Studim.

Aktakuzë që apelon drejtësi, katër vjet pas një ndodhie, emblema e së cilës ka nevojë të zbardhet

- PJESE NGA LIBRI "MOSPASJA"-

1.

Në një mëngjes çuditërisht të kthjellët janari, në Sheshin "Zogu i Parë" të qytetit të Shkodrës, janë parkuar pesë automjete të Forcave të Armatosura të Shtetit Shqiptar. Ministri i Mbrojtjes, zoti Fatmir Mehdiu, i është përgjigjur flakë për flakë kërkesës së zotërinjve Nikollë Mëhillaj e Ndoc Bjeshka që kryesojnë shoqatën "Nëntë Janari 2004", për të lehtësuar udhëtimin e familjarëve të viktimeve të një nate me pelerinë thellësisht të errët e ndjellakeqe, "nofullat" e së cilës përtpën 28 jetë njerëzore në kohën e biskimit të tyre, në drejtim të atij skaji jugor ku katër vjet më parë ndodhi një hata që është tepër e vështirë të përshkruhet

Tri orë më herët se të zbardhë dita, sheshi gjallërohet papritmas. Grupe të vogla njerëzish vijnë nga Mbishkodra e rrethinat e qytetit. Nuk është e vështirë të dallosh në fytyrat e këtyre njerëzve hijet e pikëllimit për humbjet tragjike, por dhe të "rremave" të "lisit" të mbijetesës. Një takim i heshtur mes-vedi dhe një kafe pa sheqer në Bar-in e Besës, është prologu i nisjes për larg. E vërteta është se nata e janarit 2008 ka më pak terrinë, por në memoriet e shtegtarëve kthjellimi është

tepër larg. Këta burra e këto gra, mbi të cilat ka rënë pesha e hekurit e mortit, janë përkulur nga goditja fatale që provuan atë mëngjes të Nëntë Janarit 2004, por sfidën e zbardhjes së enigmës së errët, janë të gatshme ta përballin me durim, gjakftohtësi e argumente bindëse.

Karvanit që udhëton për në jug të vendit tim, i bashkohen individë të tjerë tek Harku i Bërdicës, Kryebushati, Maba e Balldreit. Nderimi për të vdekurit e përjetshëm, është fermenti i grumbullimit. Natyrshëm ky grumbull njerëzish mund të ishte disi më i zgjeruar. Duhet ta shoqëronte këtë kortë të lavdishëm edhe ndonjë autoritet i qeverisjes vendore, ndonjë "shërbestar" i ndonjë televizioni lokal që rreth gjoksin duke thënë se "lajmi jemi ne", apo ndonjë përfaqësues i shoqërisë civile. I bëjmë me dije lexuesit tonë se numri i OJF-ve në Qarkun e Shkodrës është me tri shifra. Pak herë kemi qenë bashkë me njëritjetrin ne shqiptarët e kjo është një notë pakaluese për ne. Është krejt pak shoqërimi i grupit nga Kryetari i Shoqatës Atdhetare e Kulturore "Dukagjini", zoti Ndue Sanaj. Kujtojmë se zotëria në fjalë, së bashku me stafin e vet, është i pranishëm kurdoherë në evente

gëzimesh e hidhërimesh në komunitetin që përfaqëson. Dhe është për t'u përshëndetur ky përkushtim.

Gjithësa cekëm më sipër nuk e zbeh madhësinë e këtij rrugëtimi. Ndofta drejtësia shqiptare do të orientohet nga gjurmë të ten-tojnë të zhduken. Mos vallë mungesa i shkon për shkak alibisë së hedhur gjer më tash në "kupën e kandarit" të drejtësisë shqiptare? Për udhëtarët e heshtur të këtij mëngjesi ende të pazbardhur janari, i rëndësishëm është nderimi i çastit të ndarjes përfundimtare me të dashurit e zemrës. Ndërkohë, mos u Zot se tuten këta njerëz të thonë me plot gojën se deti e shteti, ishin ortakë në siglimin e asaj tragjedie të padëgjuar në brigjet tona ç'prej kohësh biblike. Është e drejta e tyre të ndezin qirinj e të hedhin lule në det, por edhe t'ju bien këmbanave, madje me forcë, për ta ndriçuar ndodhinë, për t'ja pastruar asaj smogun e pluhurin. Ata besojnë se njollat nuk e fisnikërojnë aspak "fytyrën" e shtetit që meritojnë shqiptarët e mijëvjeçarit të tretë pas Krishtit.

Këto e të tjera "kopsa të pakopsitura" e detyruan këtë grupim njerëzor të integrohet. Më së pari krijuan një shoqatë në shërbim

të qartësimi të situatës, kërkimit të drejtësisë si dhe të nderimit të jetëve njerëzore të humbura për shkak të "pafajësisë" së tyre. Mandej trokitën në dyert e policisë së shtetit, prokurorisë e gjykatës. Menduan t'i qetësonin shpirtrat e mbetur pezull midis dhembjes së tyre e harresës së shtetit. Formuan kolana gazetash e sekuenca emisionesh në radio e televizione. Më impulsivi i grupit, Ndoc Bjeshka që humbi djalin e vetëm Kreshnikun, shkroi dhe një libër voluminoz. E titulloi "Engjëjt e Detit Jon". Libri pikon gjak. E bukura dhe e madhërishtja janë afër e afër në faqet e këtij libri, siç janë afër e afër humbja dhe ngadhënjimi në shpirtrat e familjarëve të pikëlluar në atë farë feje saqë është e vështirë të përshkruhet.

2

Vlora e konkretisht mjedisi përballë Akademisë Detare në daljen e qytetit në drejtim të Rivierës shqiptare, është pushimi i shkurtër i karvanit të pesë Land Rovër-ve të mbushur me pjesëtarë të shoqatës "Nëntë Janari 2004". Institucioni dhe deti përballë të ndërmendin udhëtimin përmes ujërave. Madje dy tragete shihen në molon e portit. Është aventurë e këndshme t'ju bieshkryq e

Koncentrati i një krize profesionale



Vërtet të jesh malësor, po aq sa manhatas nuk është as meritë as faktkeqësi, kurse trajtimi serioz si gjetje me dinjitet e vetvetes është padyshim merita, ose fatkeqësia e cilitdo individ si njeri modern në epokën e shoqërisë së hapur si epoka e postskemave, postdogmave, posthumanizmit dhe postideologjive..

Në këtë vështrim, si njeri i lirë, si intelektual apo studiues çdo gjë që bëhet për M.Madhe, veçmas dhe përgjithësisht për vendim tim, të vogël, por më i dashuri në botë, qoftë edhe sa hapësira e një lagjeje apo e një fshati, më vjen vetëm mirë. Njëherish përfshijmë apo paragjykimi në "sofra" të tilla si "simpoziumi për Hotin" ndaj cilitdo që investohet seriozisht mund t'i shërbejë kujt, por jo konfirmimit shkencor të vlerave të M.Madhe "Nderi i kombit". Si studiues, jo i prodhuar nga mediat tona, por me status kombëtar të konfirmuar, madje edhe si firma e parë, në emër të dhënies së statusit "Nderi i Kombit" trevës sime, jam befasuar nga filozofia e përjashtimit në simpoziumin "Hoti në rrjedhat e shekujve"- Micigam, 22-23 nëntor 2013.

Kjo, sepse edhe atëhere, kur jo pak kë që abuzonte me përgjegjësitë në dëm të vendit tim, ndryshe të shqiptarëve kudo ndodhen, s'kam ngurruar ta anatemoj publikisht duke pranuar kosto sa si persekucion profesional, sa si kompromentim të sponsorizimeve ndaj botimeve të mia. Nga ana tjetër kushdo që e ka sponsorizuar këtë "simpozium", në këtë rast, kisha e Shën Palit, apo cilido biznesmen ka kryer një punë fisnike si investim financiar, por, patjetër, mendoj se duhet të nisej nga sensi FUNKSIONAL dhe jo nga THIRRJET sentimentale për një tentativë të tillë.

Drua, edhe pse nuk e dëshiroj që asnjëri nga

ato punime nuk do të "guxojnë" të botohen në mediat tona qendrore. Përvoja ime, si anëtar i Seminarit shkencor ndërkombëtar "Shkodra në shekuj" me studiues nga e gjithë bota shqiptare, më ka dhënë mësimin e duhur: Jo kushdo që tenton të ngrihet në këto podiume mund të pranohet, nëse personalisht nuk ka autoritetin minimal të botimit të një punimi të tij në mediat qendrore, profesionale të vendit. Iku koha e trajtimeve sa ideologjike, sa folklorike, trajtime "me lahutë e çifteli". Sot kërkohen studime serioze, ndryshe lexime vertikale, të thelluara që e pasurojnë, nocionin shkencor, vizionin apo këndvështrimin filozofik në fushën që tenton, aq më shumë në podiumin e një simpoziumi shkencor. Hoti, vërtet ka vlera të pamohuara, që duhen evidentuar, por jo nga një sjellje retorike, rutinierë, sepse trajtimet provinciale, patetike, folklorike sipas filozofisë së krenarisë së konsumuar, simptomë e një populli primitiv, janë, jo thjesht, jashtëkohe, por në vend të konfirmimit të një vlerë, bëjnë të kundërtën, denigrimin e saj. Jashtë zhvillimit të dyshimit metodik, si aspekt shkencor i filozofisë së kritikës totale, që tek ne e zhvilloi i pari Konica, evrocentristi më i madh shqiptar, nuk ka dhe nuk mund të ketë konkluzione shkencore, por vetëm mburrje dhe sjellje provinciale në trajtimin e një kumtese.

Pa dyshim, këto të fundit nuk ka dhe nuk mund të jenë kurrë substanca e kurrfarë lloj simpoziumi.

Sinqerisht ju uroj ta keni arritur objektivin, pavarësisht se vetëdija profesionale si kritik nuk ma lejoi të heshti deri në shkallën e shpërfilljes së një ngjarje të tillë në kontekstin e duhisë folklorike të kritikës masive si epidemi thuhet gjithë shqiptarë. Ndryshe do të bija në lojën e përjashtimit brenda vetes dhe në raport me ata që, pavarësisht statusit të tyre profesional, inicimi dhe financimi nga ana e tyre meriton nderim.

Pa dashur të anatemoj askënd, në emër të një qellimi krejt fisnik, si lexova "kumtesat", lëndë me të stërhëna dhe të stërkonsumuara, edhe në pjesën e trojeve tona, kufi me ne, u habita se si, në emër të një udhëtimi gratis deri në SHBA, kjo lloj lëndë të përbëjnë lëndën shkencore të një Simpoziumi si stisje. Në këtë kontekst ju lutem

termin historiko-shkencor, nëse nuk e njihni lexoni në fjalorët e këtij profili, sepse po më sillni ndërmend përpjekjen po kaq mjerane të ndonjë kleriku brenda Shqipërisë mëmë për ta turrur deri në rolin e një prifti fshati Mjedën, poetin tonë, më elitarin mes të gjallëve dhe të vdekurve, nga pikëpamja e mjeshtërisë artistike, në emër të një lloj klime rrethuese për bujë si plotësim egoje, pavaresisht se sa i shërben së vertetës mjedjane si profil i kthjellët akademik..Do të thoni, pse kjo?!?

E para Mjeda, pavarësisht nga manipulimet që janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen edhe sot me veprën e tij, nuk mund të mohohet që arriti të sfidojë edhe dogmën me kultdashurinë si gjëja më e shenjtë në diell. (Kujtoni vargjet tek "Andrra e jetes": Po s'i ngjet qielli/nuk i ngjet prilli/as flad qi shetit lulet/e me erna veshet/foshnjës kur i qeshet/nanës kur mbi të përkulet.(Historia e letërsisë shqiptare fq.351).

Madje poeti ynë do të arrinte të sfidonte edhe bashkëkohësit e tij evropianë: Balzakun dhe Dikensin, të cilët nën trysinë e devizës së kishës "dashuria mëkat i mishit" nuk guxuan t'i kushtohen me asnjë radhë në veprat e tyre dashurisë, aq më pak të sfidojnë dogmën duke ngritur kultin e kësaj ndjenje, kultin e dashurisë, si ndjenja më e shenjtë mbi tokë.

E dyta, po ashtu si Fishta, edhe Mjeda, krahas marrëdhënies të acaruara me eprorët klerikal, aq sa dëbohet nga urdhri fetar (1898) duke e shoqëruar edhe me shpifje, gëzoi gjithë urrejtjen e regjimit zogist, si opozitar i atij modeli autokratik mesjetar. Nëse Fishta u detyrua ta braktiste vendin e vet, pra u dëbua nga Shqipëria, Mjeda u detyrua të shkonte në Kukël. Madje, thuhet se për një vit e gjysëm ai nuk u lejua as të çonte meshë. Kështu që kushdo që tenton të plotësojë vetveten me turizmin mjedjan, kur Shkodra ka disa universitete dhe një fakultet historio-filologjie, me të drejtë masteri i nivelit të dytë, edhe pse asnjë monument të Mjedës, gabohet, sepse Mjeda, poeti ynë elegant është një pasuri kombëtare totale, e pashoqe, që do të hijeshonte mjedisin e çdo Universiteti apo Akademie, sikurse turrja e tij në rolin e një prifti fshati, nën tisin gjoja akademik përmes veprimtarish në Kukël, nën menaxhimin shiktar dhe jo akademik apo universitar, si evokim i figurës së tij, është vetëm injoruese..

Po kështu u gabua edhe në trajtesa me tisin shkencor, nën ombrellën e një relegjioni, në rastin e të ashtuquajturit simpozium historiko-shkencor kushtuar Hotit për të cilin u

fol aq pak sa vetëm simpozium për Hotin nuk mund të quhet..Kushdo investon nga xhepi i vet që të bashkojë shqiptarët, aq më shumë në Amerikë, bën një akt human dhe patriotik..E theksoj këtë, sepse po të arriheshin kaq lehtë kthesat historike në fushën e dijës, ne mund të kishim një akademi për çdo km.katrorë, prandaj kujdes o njerëz! Nëse doni që vërtet të nderoni vetveten dhe vendin tuaj, mos harroni se Evropa e Re është Evropa e vlerave të vërteta demokratike, iluministe dhe jo e manipulimeve nga asnjë lloj ideologjie. Jetojmë në epokën e postideologjive e postdogmave, dëshimi metodik ndaj tyre vjen si filozofi amerikane, ndryshe evropatlantike. Kini kurajon t'ia rritni nderën zotit të shtëpisë, kushdo qoftë ai apo ata, që u pritën me bukë dhe zemër si shqiptarë të vërtetë dhe mos gaboni të zgjateni me humorin historiko-shkencor të një "Simpoziumi" barkë justifikimi e një turizmi vetiak, nën analizën patetike të figurave të tilla serioze/ komplekse si Prekë Cali, jo hotian, nga suaza e dogmës antikomuniste duke mbajtur peng vetveten dhe habitur ata që i kanë shpëtuat së shkuarës së fronteve..Në epokën e Individiumit njeriu është i lirë të vetvendosë, por duhet të jetë shumë serioz me vetveten, aq më shumë me dinjitetin profesional që rrezikohet nga kritika masive.

Objektivisht nuk kisha asnjë mundësi të isha aty, por të heshtja do të thoshte t'ia lejoja vetes konformizmin banal me një tis shkencor, nën ombrellën e dogmave, që rrishton të zhvillohet mes nesh si një kulturë masive, apo farsë.Kjo vërtet s'që për ju kohë e humbur, por një argëtim i organizuar, në emër të një "evenimenti" që vetëm historiko-shkencor nuk mund të quhet.Më pëlqeu jashtë mase për nivelin e sinqeritetit profesional deklarimi i një miku tim, Prof. Dr.Mahir Hotit, vërtet akademik, që pohoi pamudësinë objektive të përgatitjes së një kumtese shkencore, problem që e "kishin zgjidhur" origjinalisht duke ia besuar kumtimin historik, studiuesit të UET-it, historianit Romeo, që nuk guxoi të opononte qoftë njëherë, publikisht, në mbrojtje të "Heroin të Popullit", Luigj Gurakuqi, përballë injorimit zyrtar të kontributit të Tij në 100 Vjetorin e Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Ndosh-ta për "fatin tonë dhe të "simpoziumit" e paska lënë "këtë investim" për Hotin kaq rëndshëm duke marrë mundimin akademik deri në SHBA: Ja koncentrimi i një krize profesionale si mjerimi filozofik i një simpoziumi.

Kadri Ujkaj, kritik letrare

tërthuer deteve. Por jo me gomonet e piratëve të jetëve njerëzore ama! Gomonet janë mumifikimi i kuçdrave e krokodilëve, i këtyre krijesave reale e surreale me fytyrë e nofulla përbindëshi. Syprina e detit është e qetë gjithsesi po ec e krijoje këtë imazh në memoriet e **Marta e Ndoc Bjeshkës, Nikollë Mëhillajt, Lula e Pëllumb Pecaj-t, Gjon, Age e Leze Raka-jt, Dedë e Zef Gjonit, Gjin e Vuksan Lekës, Marije e Nikollë Toka-jt...** Listimin po e ndërprisim këtu për të mos e bërë më dramatike ndodhinë. Në synorin e familjarëve dhe të afërme farefisnorë të martirëve që aspiruan për një jetë ndryshe, matanë brigjeve të këtij vendi, valët e detit janë llokoçitëse si katër vjet më herët. Të duket sikur janë valët ato që edhe sot e gjithë ditën e lume, denoncojnë krimin e përgjakshëm. Ndërkohë heshtja e përmotshme e të pranishmëve, ka gjasa të jetë në të njëjtën gjatësi vale me tallazitjen e dallgëve.

Në atë moment të shkurtër pushimi shfaqet në një tjetër profil, prokurori që denoncon krimin në atë fare feje ku më së shumti i has sharra në gozhdë. Duhet bërë një akt – padi e re në Gjykatën e Vlorës, thotë zoti Skënder Dauti. Mesazhin e përcjell me durim por edhe me një buzagaz që i ngrin atëbotë



në buzë. Partnerët shfaqen të lodhur. U ka shterrur durimi. Kanë trokitur në dhjetëra dyer të institucioneve shtetërore, por edhe të drejtësisë shqiptare. Zyrtarët e njerzit e drejtësisë tregojnë kinse kanë bërë diçka në drejtim të zbardhjes së këtij tabloidi sterrë të zi. Vërtet janë prapa hekurave ca sekserë e drejtues gomonesh, por shkaktarët e vërtetë të tragjedisë numër Dy, pas asaj të Otrantos 1997, nuk e kanë parë ende derën për tek organi i akuzës. Dy qeveritarët më të rëndësishëm të këtij vendi që kanë lidhje direkte me ndodhinë e frikshme, ish Ministri i Rendit, Iglji Toska dhe ish Drejtori i Policisë së Shtetit, Bajram Ibraj, i gëzohen ç'prej katër vjetësh një qetësie apostolike që mbase ta qetëson trupin, por jo ama shpirtin.

Biseda me **Skënder Dautin** përshkohet në celuloid. Një ekip i Televizionit Lokal të qytetit të Vlorës me emrin kuptimplotë "Focus" është aty i gatshëm për ta përcjellë shqetësimin, sa qytetar e po aq njerëzor, të kumtit postmortor. Edhe njëherë më ndërmenden reporterët e qytetit tim që pretendojnë se përcjellin në ekran botën reale të metropolit. Në rekuizitën e kësaj dite ata bëjnë mungesë. Pa kurrfarë shkaku. Nevojitet një ditë pune e një reporteri, pasi udhëtimi siç e cekëm

në krye të këtij reportazhi me shqetësim në fyt, garantohej nga Ministria e Mbrojtjes, e konkretisht nga zoti Fatmir Mehdiu. Nëntë Janari 2004 është një sumbull e zezë në historinë moderne të shtetit tim. Sumbulla e ka një lëvizje në syprinën e vet. Familjarët e martirëve për mbijetesë do të kërkojnë me durin, pa u stresuar në asnjë çast e nga askush, e me argumentet e shtetit ligjor librimin nga trysnia e mbështjelljes së fsheh misterin. Një fije shprese haset edhe në sytë plot shkëlqim të Skënder Dautit.

Karvani i vogël rinis udhëtimin në drejtim të Rivierës Shqiptare. Pa prokurorin e aktit mortor. Nën shoqërinë e reporterëve të "Focus"-it. Shurdhin, bënë dhe drejtuesit vendorë të qytetit më të rëndësishëm jugor. Bashkë me ta dhe përfaqësuesit e OJF-ve. Edhe këtu me tri shifra është numri i këtyre të fundit. Shoqëria civile nuk prokupohet për jetët e humbura në tallazet njerëzore ku xhelati identifikon viktimin dhe e lë në fatin e vet. Kuotimi në 28 i jetëve të marra me përdhunë nga deti e nga shteti, është alarmant. Për çdo shqiptar. Ja përse heshtja është një tip kallashi ani pse i dalë boje, por që flakëron ende.

Dashmir Cacaj

“BRITMA E NJË GRUAJE” NË SKENË

ROMANI I AUTORIT SHKODRAN FADIL KRAJA, PREMIERË TEATRALE NË MAL TË ZI, TUZ

Shfaqja

Në Q.K.I. “Malësia” në Tuz, me ftesë nga O.J.F. “Teatri shqip”, më 14 dhe 15 dhjetor 2013, ora 19.00, u shfaq premiera e dramës “Britma e një gruaje” nën regjinë e Idriz Gjokaj, në bashkëpunim me Gjergj Gjonaj. Shfaqja u ndjek me një interes të madh, qoftë nga autoritetet e larta vendore e jo vetëm, qoftë nga publiku i gjerë dhe u shoqërua me duartrokitje të shpeshta. Mund të thuhet se misioni i trupës së angazhuar, u krye me sukses pasi i gjithë spektatori u përfshi emocionalisht në përjetimin e ngjarjes që u dhuroi skena. Një dëshmi që e “vulos” suksesin e madh të kësaj drame është kërkesa insistuese për ta risjellë në skenë atë. Prandaj dhe, duke u nisur nga ky interesim i madh, O.J.F. “Teatri Shqip” ka vendosur që “Britma e një gruaje” të shfaqet sërish me 19 dhjetor, ora 20:00 në Q.K.I. “Malësia”, Tuz. Mysafirë të shfaqjes njoftohet se do të jenë figura të ndëruara të artit skenik si Artistja e Popullit Tinka Kurti-Nderi i Kombit, Bruno Shllaku, Agron Dizdari e te tjere.

Për këtë shfaqje kanë punuar një numër i konsiderueshëm njerëzish, profesionistë dhe dashamirës të artit: kostumografia është punuar nga Mirsada Gjokaj, skenografia nga Beqo Nanaj, përzgjedhja e muzikës nga Luigj Dedvukaj dhe realizimi teknik nga Gjon Junçaj. Ndërsa, aktorët e kësaj drame, një trupë amatore që duhet përgëzuar, janë: Marash Junçaj, Ali Beqiraj, Suzana Ujkaj, Viktor Dreshaj, Beqir Gjokaj, Lucë Junçaj, Marash Dedvukaj, Rasim Beqaj, Pashko Gjokaj, Gjeta Vulaj, Musa Gjokaj, Fran Dedvukaj, Tonin Junçaj, Besnik Gjonaj, Leon Junçaj, Marash Dukaj, Romeo Dreshaj, Gjeta Ulaj, Leon Camaj, Suzana Gjonaj, Valentina Vulaj, Merita Dedivanaj Lucaj, Flora Beqaj dhe Merita Gjokaj. Duhet përmendur se trupa amatore nuk është hera e parë që ka vënë në skenë vepra të Fadil Krajës, përmedim dramën “Tronditje”, më të cilën kanë fituar mjaft çmime.

Drama

“Britma e një gruaje” vjen si një premierë teatrale si rezultat i punës së bërë me tekstin e romanit me të njëjtin titull të autorit shkodran Fadil Kraja dhe poezisë me titull “Kupe Dania” të shkrimtarit Arshi Pipa, pjesë e vëllimit të tij “Libri i burgut”. Dramatizimi i tekstit është punuar nga Milto Kutali, profesor në Universitetin e Arteve, Tiranë.

“Bismillah” – është fjala e parë e shqiptuar që hap siparin e kësaj drame, errësohet skena dhe spektatori ftohet të kthehet shumë vite mbrapa në kohë: në shekullin e XIX-të, në kohën kur Shqipëria ishte nën sundimin osman. (Por në asnjë skenë nuk ka referenca kohore të pohuara pasi mesazhi është i qartë: këtu brennda ndodhet edhe aktualiteti dhe koha e tashme). Pas fjalës së parë, shohim një vajzë 16-vjeçare (Zoga), e cila bën kryq.

Në fakt, duke u nisur që nga titulli dhe pastaj skena e parë, publiku i vëmendshëm mund të krijojë imazhin e asaj që do të shohë në vazhdim: një femër që zgjon një komb me thirrjen e saj për bashkim.

Nxitja është sporadike: përmes konfliktit fetar (“Ndryshe kem’ Bajram e Pashkë / Besë e nder i kemi bashkë”), filtrohet nga skena në skenë, motivi kryesor i dramës: bashkimi kombëtar. Këtu vihet theksi dhe rreth këtij motivi sillen e gjithë vëmendja, qoftë nga zgjedhjet regjisoriale, qoftë nga publiku, pavarësisht se si ky i fundit mund ta kuptojë atë gjatë artikullimit të idesë së përgjithshme të premierës.

Katër janë vendet e veprimit ku zhvillohen ngjarjet dhe shpalosen karakteret: tek burimi, në kafenenë e Kupe Danes, në bedenat e kalasë, në shtëpinë e Preçit, babait të Zogës. Fati i Kupe Danes, bëhet çelësi zbërthyes i tipareve karakteristike qytetare e malësore shqiptare: besa, bujaria, nderi dhe sakrifica, tipare të mbaritura nga personazhe si Kupe Dane, Gjyl Begu, Ali Thaçi nga Kosova, Dede Gjo Luli me shokë, Abdyl Harapi etj. Këtë tablo e plotësojnë thashethemet mbi ngjarjen, nxitjet keqdashëse për përçarje mes shqiptarëve (përfaqësuar nga personazhi i Karemanit) etj. Dhënia e informacionit tek publiku, komunikimi i situatës tek ai nuk vjen ngutshëm por zbulohet gjithçka dalë ngadalë. Perspektiva që i jepet aktorit për zbërthimin e karakterit të tij mund të themi se është e kurrar mirë por artikulli mund të ishte edhe më mirë. Megjithatë, veprimi fizik ekzekutohet me kujdes sepse, më shumë se karakteri, duhet theksuar situata.

Mund të themi se për këtë premierë është punuar me parimin që shfaqja t’i shkojë sa më afër spektatorit të vet dhe të mos mbetet një dramë e destinuar për një publik specifik. E themi këtë nisur nga fakti se, në dramë, janë shtuar personaz-



he (rasti i Çun Mulës) apo janë ndryshuar paksa skenat e veprimit, që romani nuk i ka. Zgjedhja është e drejtë, sepse jo domosdoshmërisht i duhet qëndruar besnik një teksti. Kjo ndodh sepse regjisorin kërkon të luajnë me vëmendjen e spektatorit dhe të kënaqë pritshmëritë e tij. Në disa raste kjo sjell cënimin e kriterëve estetike të artit, por mund të themi se në rastin konkret, drama i shpëtoi këtij rreziku përmes gjetjeve të detajeve regjisoriale. Një rrugë e mirë që u zgjodh ishte seleksionimi. Dramaturgu dhe regjisorin kanë ditur të bëjnë zgjedhjet e duhura duke i shmangur spektatorit konfuzionin dhe duke i përqëndruar ata tek planet më të rëndësishme. Kështu ata kanë siguruar edhe një unitet e koherencë të mirë mes pjesëve, në funksion të së tërës – shfaqjes në plotësinë e saj.

Sa i përket stilit të shfaqjes, mund të thuhet se nuk ishte një regjisorë me shprehje ekzibicioniste të tepruara, përveç disa skenave pak të bujshme (vrasjet), të cilat përligjen nga vetë konflikti tematik që shoqëron ngjarjet. Tema të tilla janë zgjedhje për publikun vendas, por duket se motivet patriotike (jo në nivele patetizmi) janë edhe parapëlqime regjisoriale.

Të gjithë jemi të vetëdijshëm se në teatër, njerëzit janë më shumë të prirur të prekën nga ajo që shohin se nga ajo që dëgjojnë ndaj dhe shfaqja duhet pasuruar me detaje nga i gjithë ansambli krijues. Për këtë kanë luajtur rol mjaft të mirë, duke nisur që nga kurimi i imazhit të aktorëve me aksesoret e duhur, prania e disa personazheve njëkohësisht në skenë që krijojnë efekt vizual të fortë (në veçanti prania e figurave historike si Dede Gjo Luli e Çun Mula), ndërhyrjet e tallallit që nga “zona” e spektatorit, inserti i fragmenteve si këngë më vete (rasti i këngës “Hajredin Pasha”) apo momentet e këndimit nga 3-4 vargje prej aktorëve etj., duke eliminuar përsëritjen apo monotoninë. Edhe seleksionimi i karaktereve është i kurrar, sepse janë zgjedhur moshë, vesh, zakone, raca, besime, morale etj. të ndryshme që krijojnë mundësi për larmi dhe rrjedhimisht efekte të veçanta tek publiku. Tani spektatori mund të priste gjithçka nga kudo. Kjo strategji autoriale e bëri publikun të zhytet brenda veprimit dhe t’i lejojë vetes të ndikohet emocionalisht skenë mbas skene. Kur një premierë e arrin këtë, ka arritur suksesin dhe ka dhuruar spektaklin dramatik.

këto mungojnë? Dhe çfarë mund të themi për mungesën thelbësore: atë të teatrit? Prandaj dhe më e pakta që mund të bëjmë, është të shprehim mirënjohjen e thellë për këto artdashës, të cilët vetëm me pasionin e tyre për skenën, mposhtën pengesat e shumta, që e shoqërojnë realizimin fillim e mbarim të një premiere të tillë. Pastaj, më vonë, shpresojmë se mund të bëhet diçka më shumë nga autoritetet përkatëse e përgjegjëse.

Profil

Idriz Gjokaj është regjisor i parë profesionist që jeton e punon në Tuz, në Mal të Zi. Në vitin 2011, ai ka përfunduar studimet e larta në Fakultetin e Artit Skenik pranë Akademisë së Arteve në Tiranë (sot Universiteti i Arteve), dega Regji Teatri. Në po këtë degë, regjisorin i ri ka mbrojtur edhe titullin Master.

Gjatë studimeve, Idriz Gjokaj ka përcjellur si regjisor disa pjesë teatrale, në bashkëpunim me regjisorin dhe aktorin Andi Begolli, përmendim: dramatizimin e novelës së Koliqit me titull “Gjaku”; “Ajaksi” i Sofokliut (fragment); “Rikardi III” i Shakespeare-t (fragment); “Ariu” i Anton Chekhov-it etj. Në disa prej tyre, Gjokaj ka debutuar edhe si aktor. Përmendim gjithashtu shfaqjen e komedisë dramatike të Václav Havel me titull “Audiencia”, e punuar bashkë me Andi Begollin, e cila u shfaq në Teatrin e Metropolit në Tiranë, në Teatrin e Kukullave si dhe në Teatrin Profesionist të Gjakovës në vitin 2012.

Me komedinë “Duke prituri të hënën”, e dramaturgut argjentinas Carlos Maria Alsina, Gjokaj diplomohet si regjisor (cikli tre vjeçar Bachelor), ndërsa me pre-

Sfidat dhe mirënjohja!

Mbasi që marrim dhe pastaj përcjellim emocionin e fituar nga realizimi i shfaqjeve të tilla, pak kush kujtohet se në çfarë kushtesh i bie që të punojë një trupë teatrore, bashkë me njerëz të tjerë, komponentë të rëndësishëm për të çuar në skenë një premierë, kur nuk mbështetet institucionalisht. Çdo projekt, që gëzon mbështetjen financiare dhe infrastrukturore, të ndihmon të ecësh më mirë, më lehtë e sidomos më suksesshëm. Çfarë mund të themi në rastet kur të gjitha

mierën “Halit Gashi” (Tuz, 2012), këngë epike legjendare shqiptare, e dramaturguar nga Milto Kutali, mbron titullin Master.

Kohët e fundit, Idriz Gjokaj ka bashkëpunuar si asistent me regjisorin Boris Lijesevic në pjesën teatrale “Baballarët kanë ndërtuar” (2013). Pas premierës “Britma e një gruaje”, regjisorin Gjokaj po punon për një projekt në Teatrin Kombëtar në Podgoricë, mbi një pjesë të dramaturgut Stefan Çapaliku.

Ma. Arjeta Ferlushkaj

REDAKSIA

Kryeredaktor: Lazër Kodra

Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja